



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional

“Politika dhe Administrim”

me profil

“Administrim Financiar”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Sherif BUNDO

2. Prof. Dr. Drini SALKO

Maj/2020

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD) është institucion publik, i Arsimit të Lartë, i krijuar me VKM nr.801, dt 20.11.2005 fillimisht me tre njësi kryesore:

1. Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit
2. Fakulteti i Edukimit
3. Shkolla e Lartë Profesionale

Me vendim të KM nr.685.dt.25.08.2010, Universiteti në kuadër të riorganizimit u zgjerua me njësi kryesore (Fakultete) dhe njësi bazë (Departamente) të reja dhe aktualisht operojnë 6 Fakultete dhe mbi 97 programe studimi:

1. Fakulteti i Biznesit
2. Fakulteti i Shkencave Politike Juridike
3. Fakulteti i Edukimit
4. Fakulteti i Studimeve Profesionale
5. Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit
6. Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktiken

Programi i studimit Master Profesional në ‘Politika dhe Administrim’ me profil “Administrim Financiar” është hapur për herë të parë në vitin 2009 si program i Fakultetit të Biznesit (ish Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit). Me riorganizimin e institucionit dhe ngritjen e Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike u bë pjesë e këtij Fakulteti dhe Departamenti i Administrimit Publik si një nga tre njësitë baze të tij. Në kuadër të riorganizimit të programit rrjedhë e ndryshimeve ligjore (Ligji nr. 80/2015 dhe akteve ligjore) ky program pësoi ndryshimet e nevojshme në përmbajtje dhe strukture si një program MP me afat kohor një vit akademik dhe 60 kredite. Ky proces është shoqëruar me miratimin nga strukturat drejtuese përkatëse (Vendim i Senatit të UAMD datë 14.06.2018).

Programi mbulohet nga Departamenti i Administrimit Publik që është një nga tre njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike dhe strukturë e ngritur që me hapjen e Universitetit në vitin 2005. Ky Departament është njësi bazë akademike që zhvillon procesin e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor në fushën e Administrimit Publik. Departamenti ofron dy programe studimi të ciklit të parë Bachelor, tre programe në ciklin e dytë Master Shkencor, dhe një program Master Profesional në “Politika dhe Administrim” me tre profile ku profili “Administrim Financiar” është dhe programi për tu vlerësuar në këtë raport.

Ky program ka pësuar ndryshime në kuadër të riorganizimit të tij. Riorganizimi i fundit përkon pas miratimit të Ligjit aktual për arsimin e lartë dhe që u zbatua në vitin akademik 2018-2019 miratuar me vendimin e MASR nr.7241/1 datë 31.08.2018. Tashmë për këtë program, UAMD është në proces akreditimi.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Grupi i vlerësimit të jashtëm i miratuar nga Bordi i Akreditimit dhe ASCAL, dhe përfaqësuesi i këtij institucioni, në rolin e koordinatorit teknik, në realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm u mbështet në një seri dokumentesh dhe kërkesash të ndryshme në lidhje me standardet dhe mënyrën e funksionimit të njësive përkatëse që mbulojnë këtë program. Burim i rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm shërbeu Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i cili ishte rezultat i bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ dhe pasqyronte situatën e procesit të formimit dhe të zhvillimit në Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike, Departamentin e Administrimit Publik. Një rol të rëndësishëm në këtë vlerësim kanë dhe vizitat në vend që u realizuan pranë UAMD në datat 20-21 Shkurt 2020, takimet me drejtues dhe njësi përgjegjëse të këtij institucioni si dhe shqyrtimi i dokumentacionit bazë mbi të cilën organizohet i gjithë programi i studimit.

Gjatë vizitës në Institucion u realizuan takime me drejtues të tij, me drejtues të Departamentit, NJSBC, Stafin pedagogjik që mbulon programin, Studentë, Sekretarinë Mësimore, Administratën, Arkivin, në bibliotekë etj. Gjithashtu u bë vizitë në mjediset mësimdhënëse të këtij Institucioni, në sallën e kompjuterëve.

Në verifikimin e të dhënave u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionet për verifikim. Kjo metodë u përdor në verifikimin e të dhënave lidhur me cilësinë e studentëve, me të dhënat e studentëve në sekretari, me të dhënat për hyrje dhe dalje të studentëve në vite dhe lidhur me frekuentimin e leksioneve dhe të seminareve.

Gjithashtu, gjykimi i grupit të vlerësimit të jashtëm u mbështet në intervistat e marra nga grupet e ndryshme të interesit (drejtues, grupi i vlerësimit, stafi pedagogjik, studentë, punonjës të administratës, etj).

Së fundi vlerësojmë bashkëpunimin me gjithë strukturat përkatëse të Institucionit që na mundësuan plotësimin e kërkesave tona lidhur me aspekte të caktuara në shërbim të një vlerësimi sa më objektiv.

Më datë 05.05.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 4/43 Prot., datë 07.05.2020, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 12.05.2020.

Shënim: Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm, ka ardhur si pasojë e kushteve të jashtëzakonshme pas tërmetit të 26 Nëntorit dhe pandemisë së COVID-19. Komunikimi me IAL-në është berë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132 datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91 date 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190 datë 19.03.2020.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin I.3, Kriteri 3**,



GVJ konkludon që **raporti në këtë pikë nuk ndryshon**. Këtë e bazojmë në argumentet e shprehura në raport. Rekomandimet tona janë mëse të realizueshme në kuadër të hapësirës së lejuar të ndryshimeve në kurrikul gjatë vitit të ardhshëm akademik.

2. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin II.1, Kriteri 1 dhe Standardin II.3 Kriteri 4,**

GVJ konkludon që **raporti në këtë pikë nuk ndryshon**. Këtë e bazojmë në argumentet e shprehura në raport. Elementët e ngarkesës për lëndë të caktuara kërkojnë edhe angazhim të ndryshëm jashtë auditorit nga studentët gjë që reflektohet edhe në numër kreditesh të ndryshëm për disa lëndë.

3. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin II.1, Kriteri 3,**

GVJ konkludon që **raporti në këtë pikë nuk ndryshon**. Konstatimet tona bazohen nga analiza e syllabusit përkatës por që në kuadër të rishikimit të tij mund të axhustohen duke u lehtësuar nga ngarkesa teorike.

4. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin II.1, Kriteri 6,**

GVJ konkludon që **raporti në këtë pikë nuk ndryshon**. Edhe nga vetë komenti i institucionit rekomandimi i GVJ konsiderohet plotësisht i realizueshëm .

5. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin II.4, Kriteri 5,**

GVJ konkludon që **raporti në këtë pikë nuk ndryshon**. Argumentet e dhëna nga GVJ edhe në pjesë të tjera të këtij raporti justifikojnë rekomandimet e dhëna.

6. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin II.5, Kriteri 1,**

GVJ konkludon që **raporti në këtë pikë ndryshon**. Konstatohet se përmbushja e kriterit ligjor ku stafi PAE duhet të mbulojë jo më pak se 70 % të ngarkesës totale të programit është pothuajse në kufirin e tij. Bazuar në faktin se 3 % i tejkalimit të orëve përtej kufirit të lejuar i përket profesorëve të ftuar, një saktësim i planit të ngarkesës rregullon edhe këtë problem. (Shih ndryshimin në raport)

7. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin II.6, Kriteri 4,**

GVJ konkludon që **raporti në këtë pikë nuk ndryshon**. GVJ vlerëson që për vetë faktin që kemi të bëjmë me një program të veçantë që lidhet me mundësitë e punësimit vetëm në sektorin e administrimit financiar publik, përpjekjet e institucionit për bashkëpunim më të frytshëm dhe të koordinuar me institucionet e këtij sektori duhet të jenë më intensive dhe me rezultate konkrete.

8. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin III.3, Kriteri 2,**

GVJ konkludon që **raporti në këtë pikë ndryshon**. Bazuar në informacionin shtesë ku krahas laboratorit të informatikës, që të ofrojnë kapacitetet e mjaftueshme për zhvillimin e mësimit në lëndë të këtij program institucioni ka dhe marrëveshja me Crystal System shpk që krijon mundësi të përshtatshme për studentet e programit të zhvillojnë lëndë të Kontabilitetit dhe Financës në përmbushje të aftësive praktike të tyre. (shih ndryshimin në raport).

9. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardin III.3, Kriteri 3,**

GVJ konkludon që **raporti në këtë pikë nuk ndryshon.** GVJ mendon se edhe pse problematika e vërejtur ka premisat të realizohet, ajo ende është evidente në këtë periudhë vlerësimi.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit të ciklit të II-të Master Profesional (MP) në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar” ofruar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD)/ Fakulteti i Shkencave Politike Juridike në të gjithë komponentët e tij nuk bie ndesh me interesat kombëtare por i shërben këtyre të fundit <i>(Aneksi nr. 1, 6.1 dhe 7)</i>			
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi MP në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar” është hartuar në zbatim të Ligjit në fuqi për Arsimin e Lartë, akteve nënligjore dhe kuadrin rregullues të tij si dhe në Strategjinë Afatmesme të UAMD-se. Ky program reflekton vlerat akademike e kulturore standarde të arsimit të lartë në Shqipëri. Ky vlerësim bazohet në plotësimin e kriterëve thelbësorë të këtij programi në aspektin akademik dhe atë kulturor bazuar në Statutin e Institucionit <i>(Aneksi nr. 1)</i>			
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Ky program studimi është hartuar në mbështetje të qëllimit dhe misionit të UAMD-së të shprehura në strategjinë e zhvillimit të institucionit me fokus përgatitjen e studentëve me njohuritë bashkëkohore teorike praktike në fushën e Administrimit në përgjithësi dhe Administrimit Financiar në veçanti. Në zbatim të kësaj strategjie është edhe ngritja e njësisë bazë të këtij programi, Departamentit të Administrimit Publik, si pjesë e Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike të UAMD-së. Ky program plotëson më mirë nevojat në fushën e veprimtarisë ekonomike të lidhura me politikat e administrimit ekonomik e financiar. <i>(Aneksi nr. 1, 6, 6.1, 7 dhe 10)</i>			
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Ky program studimi ofron mundësi për të plotësuar tregun e punës në fushën e Administrimit Financiar në sektorin publik në nivel kombëtar dhe kryesisht atë lokal <i>(Aneksi nr. 73 dhe 73.1)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi I.2				
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit MP në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar”, është hartuar në përputhje me strategjitë e zhvillimit të UAMD. Ky program që e ka filluesën e vet që në vitin 2009-2010 u zhvillua fillimisht në zbatim të strategjisë se zhvillimit të institucionit për periudhën 2010-2016 dhe është riorganizuar në funksion të strategjisë se zhvillimit të institucionit për periudhën 2016-2020 dhe Planin e Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike (FSHPJ). (Aneksi nr. 4, 6 dhe 6.1)			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statuti dhe rregullorja e UAMD-së përcaktojnë shtyllat kryesore ku mbështetet gjithë veprimtaria akademike dhe shkencore e institucionit. Krahas kësaj baze rregullative edhe vet njësia bazë, Departamenti i Administrimit Publik që mbulon këtë program ka rregulloren përkatëse ku janë të përcaktuar edhe drejtimit kryesore të këtij programi. Kjo rregullore është rishikuar dhe miratuar në Nëntor të vitit të kaluar duke reflektuar edhe ndryshimet ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi. (Aneksi nr.1 dhe 2)			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Ky program është në unison me fokusin dhe drejtimit kryesore akademike, shkencore dhe profesionale të FSHPJ-së dhe njësisë bazë të tij Departamentit të Administrimit Publik duke fokusuar problematiken e administrimit ekonomik dhe financiar në sektorin publik, një drejtim ky jo shumë i mbuluar nga shumica e IAL-ve në vendin tonë. (Aneksi nr. 2 dhe 6)			
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Një nga drejtimit e strategjisë kombëtare të zhvillimit ekonomik është dhe Administrimi Financiar që lidhet me miremenaxhimin e pasurisë lokale e kombëtare në sektorin publik dhe privat. Në këtë këndvështrim ky program studimi është në shërbim të përgatitjes se studentëve me njohuritë teorike por para së gjithash praktike në fushën e Administrimit Financiar me fokus sektorin publik. Kjo e bën më tërheqëse marrjen e njohurive në fushën e Administrimit Financiar publik që ende shoqërohet me shumë mangësi. Në programin e studimit të detajuar, shohim se lëndët karakterizuese mbulojnë objektin e administrimit financiar publik, një sektor ky i rëndësishëm që ende vuan nga efektiviteti i ulët i menaxhimit të mjeteve dhe fondeve financiare. (Aneksi nr. 6, 6.1, 7 dhe 11)			
Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet




standardit	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar”, ka të përcaktuar qartë objektivat e tij pasi në përfundim të tij studentët marrin njohuri teorike praktike në fushën e administrimit publik me fokus Administrimin Financiar. Objekti i këtij programi studimi në Administrimin Financiar është me i fokusuar në sektorin publik duke qënë në përputhje edhe me drejtimin e njësisë bazë që mbulon këtë program, Departamentin e Administrimit Publik. <i>(Aneksi nr. 73)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike dhe sidomos Departamenti i Administrimit Publik kanë realizuar dy studime mbi tregun e punës lidhur me studentët që do të përfundojnë këtë program studimi. Në fazën e riorganizimit të këtij programi në vitin 2017 Departamenti ka realizuar studimin e parë me qëllim argumentimin e riorganizimit të programit dhe në Korrik 2019 ka realizuar studimin e dytë të tregut të punës. Në studim u përfshinë dy grupe kryesore; Administratorët Publik dhe Studentët e vitit të tretë Bachelor. Në këtë kuadër u mor informacioni i dëshiruar lidhur me nevojat e tregut të punës për administrator financiar në sektorin publik si dhe drejtimet e vazhdimet të programit të ciklit të dyte për studentët Bachelor, të dhënat e të dy studimeve janë të analizuarra gjerësisht duke përmbushur standardet e një studimi cilësor. <i>(Aneksi nr.73)</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nëvojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit shohim që në tërësin e vet ky program bazohet në objektiva formuese të qarta dhe strukturë të përshtatshme që janë në funksion të dijeve dhe aftësive të studentëve në tregun e punës. Ky program tashme i ristrukturuar në kuadër të kërkesave ligjore dhe rregullative me kohëzgjatje 1 vit akademik arrin në përgjithësi ti përgjigjet nevojave të tregut të punës sidomos në sektorin e Administrimit Financiar publik. <i>Duke parë më me detaje programin vërejmë se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Si një programi mësimor i nivelit Master Profesional me 60 kredite ai duhet të jetë i dominuar nga lëndë teorike praktike me orientim profesional. Në këtë kuadër,</i>




	<p><i>mendojmë se programi duhet të lehtësohet nga lëndë që janë kryesisht të karakterit shkencor. Në kuadër të hapësirës së lejuar të ndryshimeve në kurrikul mendojmë që lëndët “Metoda Cilësore dhe Sasiore në Kërkim” dhe “Makroekonomi e Avancuar” mund të zëvendësohen me lëndë më profesionale të lidhura me administrimin financiar.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Në kurrikul janë të përcaktuar një numër i larte i lëndëve me zgjedhje përkatësisht 13 të tilla kundrejt 2 mundësive për zgjedhje (një lëndë me zgjedhje për secilin semestër) Mendojmë që ky numër mund të reduktohet duke mos përfshire lëndë të tilla që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me Administrimin Financiar. Kjo do ta bënte më të lehtë për studentët zgjedhjen e dy lëndëve me natyrë karakterizuese të këtij programi. Lëndë të tilla si: “E Drejtë Kushtetuese e Avancuar”; “Organizatat Ndërkombëtare”; Marrëdhënie Ndërkombëtare”; “Sjellje Organizative”, janë larg objektivave të këtij programi.</i> • <i>Në program të gjitha lëndët që zhvillohen së bashku me praktikën mësimore dhe diplomimin janë të vlerësuar me të njëjtët kredite që konkretisht është 6. Mendojmë që për lëndë të ndryshme mund të kemi numër kreditesh të ndryshme bazuar në sistemin e përcaktimit të tyre që bazohet në nivelin e angazhimit në auditor dhe jashtë tij dhe karakteristikat e ndryshme që kanë lëndët mes tyre.</i> <p><i>(Aneksi nr. 24)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimit të studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Nga shqyrtimi i këtij programi studimi mendojmë se ai përafrohet me programe të ngjashme studimi në Universitete homologe të vendeve të tjera që fokusohen në administrimin publik në përgjithësi dhe Administrimin Financiar në veçanti.</p> <p><i>(Aneksi nr. 24)</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Ky program studimi është ristrukturuar bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi. Ristrukturimi është fokusuar në cilësinë e mësimdhënies, në zhvillimin e tij kryesisht me staf efektiv dhe vazhdimësinë e programit me të gjitha ndryshimet në të. Programi bazohet tashmë në Kartën e Bolonjës që përcakton ndarjen e grupimit të lëndëve në kurrikulën e programit MP në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar” në variantet me 60 ECTS, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira bashkëkohore.</p> <p><i>(Aneksi nr. 36 dhe 74)</i></p>




<p>Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në fushën e administrimit publik dhe atë financiar duke synuar që të rrisë edhe aftësitë praktike që përfshijnë fushën e mësipërme.</p> <p>Mbështetur në 8 lëndët që ofron programi por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorike shkencor dhe relativisht edhe atë profesional të studenteve. Në këtë kuadër, praktika profesionale dhe përgatitja e diplomës që synohet të jetë aplikative i shërbejnë këtij objektiv në rritjen më shumë profesionale të studentëve. Nga verifikimi ynë praktika profesionale realizohet kryesisht pranë institucioneve publike në degët e financës së tyre.</p> <p>Bazuar në emërtimin e programit ky program është në përputhje me orientimet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Emërtimi i programit është në përputhje jo vetëm me drejtimin e tij në Administrim Financiar në sektorin publik por plotëson më mirë kërkesat për specialistë dhe menaxherë që kërkohen nga ky sektor me formim kryesisht profesional (Aneksi nr. 9)</p>			
<p>Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program zotëron gjuhë të huaja të vendeve të BE dhe mund të zhvillojë leksione në këto gjuhë. Nisur nga fakti që kemi të bëjmë me një program MP ku nuk është e detyrueshme zotërimi i gjuhës se huaj për një numër studentësh nuk mund të zhvillohet mësimi në gjuhë të huaja. (Aneksi nr. 24)</p>			
<p>Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>Ky program ka një profil të veçantë pasi synon të kualifikojë studentët në menaxhimin financiar me fokus sektorin publik (Aneksi nr. 73 dhe 73)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi I.4 Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi</p>	<p>Organizimi i UAMD, struktura e tij hierarkike është e ndërtuar në mënyrë të tillë që të përmbushë misionin dhe objektivat e përcaktuara prej tij por edhe të programit MP në “Politika dhe</p>




studimi në atë fushë.	<p>Administrim” me profil “Administrim Financiar” duke pasur edhe përvojën, kapacitetet dhe burimet humane të përshtatshme për një mision të tillë. Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike dhe Departamenti i Administrimit Publik që mbulon këtë program studimi arrijnë që nëpërmjet kualifikimit të nevojshëm dhe kapaciteteve që ato kanë të realizojnë me sukses zhvillimin e programit. Kështu, bazuar në organigramën e Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike ai përfshin tre Departamente dhe ka një personel me kohë të plotë prej 73 persona nga të cilët 62 janë personel akademik. Personeli akademik me kohë të plotë ka në përbërjen e tij 2 anëtarë me titullin akademik Prof.Dr; 17 anëtarë me titullin akademik Prof.Asoc; 36 anëtarë me gradën shkencore “Doktor” dhe 7 anëtarë me diplomën “Master”.</p> <p>Departamenti i Administrimit Publik si njësi bazë që mbulon këtë program gjatë 4 viteve të fundit ka rritur kapacitetet akademike dhe shkencore të stafit duke pasur në vitin akademik aktual një staf PAE prej 16 anëtarësh ndaj 9 anëtarëve që ka pasur në vitin akademik 2016-2017. Në vitin akademik aktual stafi i Departamentit përfshin 2 anëtarë me titullin akademik Prof.Dr; 3 anëtarë me titullin akademik Prof.Asoc; 7 anëtarë me gradën shkencore “Doktor” dhe 4 anëtarë me diplomë të nivelit “Master”. Në mbështetje të procesit mësimor gjatë këtyre viteve pranë këtij Departamenti janë angazhuar si personel i ftuar dhe 8 anëtarë.</p> <p>Kapacitetet humane akademike që mbulojnë këtë program studimi për vitin akademik 2019-2020 përbëhen nga 12 anëtarë që bëjnë të mundur zhvillimin me sukses të programit nga të cilët 4 janë personel akademik me kohe të pjesshme.</p> <p><i>(Aneksi nr. 30, 81, 120 dhe Evidenca shtesë Tabela e stafit akademik të programit dhe Tabela e personelit akademik të programit të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është relativisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për këtë program studimi që është Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike si një ndër Fakultetet e UAMD.</p> <p><i>(Aneksi nr. 19, 20 dhe 46)</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është plotësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi që është Departamenti që mbulon këtë program i cili që në emërtim është</p>

studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	i njëjtë me objektivin e këtij programi. Departamenti i Administrimit Publik është njësia bazë përgjegjëse misioni i të cilit përputhet plotësisht me programin jo vetëm në emërtim por para së gjithash në kualifikimin e stafit në fushën e administrimit publik. (Aneksi nr. 20, 43 dhe 95)			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Programi i studimit MP në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar” është brenda profilit të UAMD dhe Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike. (Aneksi nr. 19 dhe 46)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Njësia bazë mësimore shkencore e realizimit të programit MP në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar” është Departamenti i Administrimit Publik. Departamenti operon në dinamikën e tij duke zhvilluar takime dhe diskutime periodike për problematikën e mësimdhënies, kërkimit shkencor etj. Ndër funksionet kryesore të Departamentit përmendim: shqyrtimin dhe miratimin e planeve mësimore, programeve të lëndëve (syllabuseve) si edhe propozimin e ndryshimeve që gjykohen të nevojshme; shqyrtimin dhe miratimin e propozimeve të përgjegjësve të grup- lëndëve për tekstet mësimore që do të përdoren në lëndët e programit të studimit; ndjekjen e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar dhe mbikëqyrjen e cilësisë së mësimdhënies. Përgjegjësitë e kësaj njësie bazë si dhe të hallkave të tjera të Fakultetit janë të mirë përcaktuara në rregulloren përkatëse të funksionimit të Departamentit dhe në rregulloren e Fakultetit. Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për vlerësimin e performancës së personelit akademik të Departamentit gjatë vitit akademik. Kjo përfshin kryesisht korrektesën e tij në respektimin e orarit të punës, zhvillimin e mësimi dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera akademike si edhe cilësinë e

	mësimdhënies në auditor dhe veprimtarinë e tij shkencore. (Aneksi nr. 6, 19 dhe 120)			
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se UAMD ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshesh me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit dhe brenda vendit si dhe me një numër institucionesh të tjera të pushtetit qendror dhe vendor dhe me subjekte ekonomike publike dhe private. Këto marrëveshje përfshijnë shkëmbime reciproke të vizitave akademike shkencore si dhe marrëdhënie të tjera reciproke në fushën e kualifikimit, shkëmbimit të eksperiencave, realizimit të praktikave mësimore etj. (Aneksi nr. 58)			
Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Ekzistojnë një sërë marrëveshesh me institucione dhe njësi ekonomike publike dhe private shpesh të përcaktuara edhe me afate lidhur me realizimin e praktikës së studentëve. Në vitin aktual akademik studentët e këtij programi e kanë të garantuar realizimin e praktikës në një nga institucionet publike vendore. (Aneksi nr. 58 dhe 59)			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	Në realizimin e praktikës profesionale hartohet kontratë e përbashkët mes UAMD dhe entit përkatës në funksion kjo edhe të natyrës se programit studimor. GVJ verifikoi që paketa e praktikës që pajisen studentët përfshin krahas kontratës se nënshkruar nga të dy palët edhe udhëzuesin e praktikës dhe stafin përgjegjës që monitoron këtë proces. (Aneksi nr 58 dhe 59)			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Gjatë zhvillimit të procesit mësimor janë realizuar disa leksione të hapura praktike me studentët me tematikë praktike nga specialistë të ardhur nga institucionet publike. (Aneksi nr. 59)			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Departamenti i Administrimit Publik si njësia bazë që mbulon këtë program lidhur me këtë komponent të programit përfshin në raportin vjetor dhe analizën vjetore në departament, problematikën e praktikës profesionale. Këtë GVJ e evidentoi gjatë takimit me stafin e Departamenti.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet et plotësisht
				X




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit MP në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar” që tashmë është në kuadër të riorganizimit është bazuar në plotësimin e kërkesave ligjore dhe rregullative në përputhje me udhëzimet e MASR dhe lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS.</p> <p><i>Duke shqyrtuar planin mësimor vëmë re që numri i krediteve për të gjitha nga 8 lëndët e përfshira në program janë vlerësuar me 6 kredite. Mendojmë që bazuar në metodologjinë e përcaktimit të krediteve për lëndët e veçanta si dhe në mjaft eksperiencën të programeve në Universitete të tjera, numri i krediteve të përcaktuara duhet të luhet në funksion të ngarkesës (angazhimit) në auditor dhe jashtë tij të studentit. Në këtë gjykim lëndë të caktuara karakterizuese mund të kenë një numër kreditesh me të lartë se të tjerat apo lëndët me zgjedhje. Kjo rrjedhë e vështirësive apo orëve të angazhimit jashtë auditorit që për lëndë të ndryshme mund të jenë më shumë.</i></p> <p>Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë programit MP në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar” nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 60 kredite.</p> <p><i>(Aneksi nr. 24)</i></p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme dhe specifike kryesisht në fushën e Administrimit Financiar në sektorin publik. Mjafton të përmendim që mbi 50 % e lëndëve të zhvilluara fokusohen në administrimin në sektorin publik. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive praktike që përfshijnë fushën e Administrimit Financiar.</p> <p>Mbështetur në 8 lëndët që ofron programi por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik shkencor dhe relativisht edhe atë profesional të studentëve. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e diplomës që synohet të jetë aplikative i shërbejnë këtij objektiv, rritin më shumë përgatitjen profesionale të studentëve.</p> <p><i>(Aneksi nr. 24)</i></p>
<p>Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të</p>	<p>Programi bazohet mbi njohuritë e marra në ciklin e parë të studimit. Nga shqyrtimi i syllabusve vihet re që ka një trajtim të shpejtë të koncepteve të drejtimit financiar që janë marrë në programin Bachelor. Ky trajtim është i domosdoshëm në kushtet</p>




<p>kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>kur në këtë program kanë mundësinë që ta ndjekin edhe studentët që nuk kanë mbaruar studimet e ciklit të parë në fushën e financës apo ekonomisë. Nga ana tjetër lëndë të caktuara si “Ekonomiksi i Sektorit Publik i Avancuar” japin mjaft trajtime të avancuar ku përfshihen teoritë moderne të drejtimit që deri diku mund të konsiderohen si një “ngarkese akademike e tepërt” për një program një vjeçar MP. (Aneksi nr. 24)</p>
<p>Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të në vojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi studimor ofron njohuri të avancuar në fushën teorike shkencore por dhe të natyrës praktike në fushën specifike të administrimit në sektorin publik. E rëndësishme është që në këtë program arrihet të merren edhe njohuri mbi qeverisjen e financave të pushtetit qendror dhe para se gjithash të pushtetit vendor. Kjo e fundit përben edhe një specifike të kualifikimit të studenteve të këtij programi. Qeverisja e financave vendore (njohuri rreth të cilit ofron ky program) tashmë është një sfidë e financave publike dhe një segment i tregut ende i paplotësuar me specialist të kësaj fushe. (Aneksi nr. 24)</p>
<p>Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i këtij programi studimor rezulton se ai përfshin të gjithë elementet strukturor të përcaktuara në aktet ligjore (Ligji Për Arsimin e Lartë nr.80/2015) dhe rregullative që kanë objekt arsimin e lartë në Shqipëri, të tilla si numrin e krediteve, kohëzgjatjen e tij, sistemin e vlerësimit me kredite, etj. (Aneksi nr. 24)</p>
<p>Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi studimor ofrohet me 60 ETCS (ku përfshihen 8 lëndë, praktika profesionale dhe detyrimet përmbyllëse) dhe me kohëzgjatje 1 vit akademik. Bazuar në VKM nr.41, datë 24.01.2018 sipas kategorizimit të lëndëve të paraqitura në programin e studimit rezulton se: Lëndët bazë kategoria A zënë 30 % të numrit të krediteve ndaj 5%-10% që përcaktohet në këtë vendim. Ndërsa lëndët e kategorive B dhe C zënë secila respektivisht 30 % (vendimi e përcakton 30% deri 40 %) dhe 20 % (vendimi e përcakton 20% deri 30%). Kategoritë D dhe E kanë kredite në përputhje me vendimin. <i>GVJ mendon që edhe në kuadër të sugjerimeve mbi lëndët e programit të dhëna më lart mund të shtohet me një lëndë kategoria e lëndëve karakterizuese B (në pamundësi të shtimit të një lëndë të re karakterizuese mund të konsiderohet si e tilla lënda “Ekonomiksi i Sektorit Publik i Avancuar që është konsideruar si lëndë e Kategorise A) dhe të plotësohet ky kriter. Lënda “E Drejta Financiare e Avancuar” mund të kalojë tek lëndët e kategorisë C , gjë që do të ishte brenda kriterit të</i></p>




	<i>vendimit.</i> (Aneksi nr. 27)			
Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	Bazuar në kurrikulen dhe planin mësimor ky program parashikon ngarkesën totale të krediteve 60 ECTS ku praktika profesionale ka 6 kredite që janë llogaritur me 150 orë pune për student të ndara në ngarkesë direkte në institucionin ku do kryej praktikën dhe ngarkesë individuale të përgatitjes së studentit në këtë komponent.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	UAMD në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave si Institucion është i organizuar dhe i përberë me një strukturë hierarkike të tillë që të përmbushë dhe objektivat e programit MP në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar”. Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike si njësi kryesore (një nga 6 Fakultetet e Institucionit) dhe Departamenti i Administrimit Publik si njësi bazë që mbulon zhvillimin e këtij programi, përmbushin kriteret ligjore dhe kriteret e akteve nënligjore në fuqi. Këto dy njësi janë konsoliduar gjatë 10 viteve të fundit që nga themelimi i tyre duke përberë një bazë të fuqishme në riorganizimin e këtij programi studimi në vitin 2018. <i>(Shih standardin 1.4; kriteri 1 si dhe Anekset shtesë Të dhëna për stafin akademik)</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Departamenti i Administrimit Publik me një historik që nga themelimi i UAMD në vitin 2005 si një nga tre njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike plotëson kriteret ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike . <i>(Shih standardin 1.4; kriteri 1 si dhe Anekset shtesë Të dhëna për stafin akademik)</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Departamenti i Administrimit Publik në vitin aktual akademik ka në përbërjen e tij 16 anëtarë PAE (nga 9 anëtarë në vitin akademik 2016-2017) ndër të cilët 2 Prof.Dr.; 3 Profesorë të Asociuar, 7 Doktorë dhe 4 Asistentë Lektorë. Ky Departamenti që mbulon këtë program ka të përcaktuar misionin dhe objektivat e zhvillimit të tij. Personeli akademik i Departamentit




	i përgjigjet si kërkesave ligjore ashtu edhe nevojave të institucionit për nivelin e kualifikimit. Departamenti angazhon si pedagog me kohë të pjesshme 28 anëtare nga të cilët 8 janë personel i ftuar me tituj akademik Prof.Dr dhe Prof.As.Dr. (Aneksset shtesë Të dhëna për stafin akademik si dhe shih standardin 1.4 kriteri 1)			
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Departamenti i Administrimit Publik me numrin aktual të personelit efektiv plotëson detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën ligjore. Departamenti i Administrimit Publik angazhon një staf prej 12 anëtarësh për realizimin e këtij programi nga i cili 8 janë PAE dhe 4 PAK. (Aneksin nr. 81 dhe Aneksset shtesë Të dhëna për stafin akademik)			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.	Për realizimin e praktikave Departamenti angazhon anëtare te tij te cilët ndjekin ecurinë e praktikës së studenteve. Nga shqyrtimi i dokumentacionin ekzistojnë paketa të praktikës profesionale si dhe udhëzime për këtë komponent të programit. (Aneksi nr. 67 dhe 68)			
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti i Administrimit Publik në rregulloren e brendshme të tij miratuar me vendimin nr. 9 datë 8.11.2019 në nenin nr. 9 përcakton koordinatorin e programit të studimit si autoritet të këtij Departamenti dhe në nenin numër 17 përcakton të detajuar detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Nga vizita në institucion GVJ verifikoi zbatimin e kësaj rregulloreje lidhur me koordinatorin e programit.			
Kriteri 7. Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike të drejtuesit të njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	Koordinatori i këtij programi ka udhëhequr dhe ndjekur gjithë procesin e riorganizimit dhe ka koordinuar punën për përgatitjen e gjithë dokumentacionit përkatës si dhe analizën, vlerësimin dhe raportimin e problematikes së dalë gjatë zhvillimit të gjithë procesit mësimor. (Bazuar në takimin me stafin akademik)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin,	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të prezantuar nga Departamenti i Administrimit Publik dhe nga verifikimi në vend gjatë vizitës në institucion rezulton se njësia bazë disponon informacionin e nevojshëm mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e

strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	programit të studimit dhe jo vetëm si evidencë por dhe të bërë publike në website e UAMD. (Aneksi nr. 24, 86, 87 dhe 88)
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Ky program studimor përmban të gjithë elementët e përcaktuar në Ligjin nr.80 datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL” si dhe Vendimin e KM nr.41 datë 24.01.2018.
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi përmban 8 lëndë, praktikën profesionale, mbrojtjen e diplomës etj, të vlerësuara me sistemin ECTS. (Aneksi nr. 24 dhe 27)
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e në vojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Programi që përfshin një numër total prej 60 ECTS në strukturë është i ndarë në ore në auditor, orë në aktivitete të tjera si projekte, orë studimi individual, elementë këto matës të sistemit ECTS. Ngarkesa mësimore prej 1500 orësh është e ndarë në mënyrë të barabarte në dy semestrat e vitit akademik. <i>E rritheksojmë se këto elementë të ngarkesës janë të njëjtë për çdo lëndë gjë që mund të mos ketë marre në vlerësim lëndë të cilat mund të kërkojnë më shume angazhim se të tjerat. Mendojmë që bazuar në metodologjinë e përcaktimit të krediteve për lëndet e veçanta si dhe në mjaft eksperiencë të programeve në universitete të tjera numri i krediteve të përcaktuara për të dy lëndët me zgjedhje që janë 6 kredite mund të ulet në 3 apo 4 kredite dhe për lëndë të detyrueshme si “Drejtimit Financiar i Avancuar në organizatat Publike” apo “Ekonomiksi i Sektorit publik i Avancuar” të rritet. Kjo rrjedhje e vështirësive apo orëve të angazhimit jashtë auditorit që për lëndët e propozuara mund të jenë më shumë.</i> Gjithashtu, studentët në fillim të secilit semestër informohen gjërësisht dhe pajisen me të gjithë syllabuset e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar. Ky informacion tashmë është edhe elektronikisht, ku çdo student shih gjithë materialet e lëndës që pedagogët vendosin në portal, krahas syllabusit (Aneksi nr. 24 dhe 27)
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e në vojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Studentët kandidatë për tu regjistruar në këtë program si dhe ata që vazhdojnë procesin mësimor marrin informacion mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> • Rregullores së studimeve të UAMD • Rregullores së Departamentit të Administrimit Publik • Rregullores së programi MP ne “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar”




	<ul style="list-style-type: none"> • Informacionin e dhënë nga koordinatori i programit (Aneksi nr. 19, 20 dhe 46)
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e në vojshe për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit rezulton se ai përfshin gjithë elementët përbërës formues teorike praktik për një program të nivelit MP. Nga shqyrtimi i syllabuseve vërejmë se ato përmbajnë të gjithë elementët e përcaktuara në Vendimin e KM nr.41 datë 24.01.2018 si :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimi i lëndës/modulit • Viti/semestri kur zhvillohet lënda • Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën • Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit • Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetimin e lëndës • Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë • Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik • Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS • Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre • Format e vlerësimit të studentëve • Detyrimet e studentit për lëndën • Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse <p>Gjatë vizitës pranë institucionit GVJ vlerësoi cilësinë e syllabuseve të programit dhe njëkohësisht krahasuam ato me syllabuset e prezantuara në dosjen e Vetëvlerësimit të Institucionit. Hartimi i syllabuseve të programit përfshin të gjitha elementët e nevojshëm duke plotësuar kriteret për to.</p> <p>Nga verifikimi i GVJ gjatë vizitës në institucion rezulton kontroll periodik i njohurive të marra me anë të testeve apo provimit përfundimtar. Format e mësimdhënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provim final. Përkatesisht studenti vlerësohet, 20% nga detyra e kursit; 30% nga provimi i ndërmjetëm; 50% në provimin përfundimtar.</p> <p>(Aneksi nr. 100, 101 dhe 102)</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Në kuadër të riorganizimit të këtij programi GVJ konstaton që ai ka pësuar ndryshime të vazhdueshme me synim përmirësimin e tij. Kjo shihet në ndryshimet në lëndë të caktuara të cilat janë miratuar në njësinë bazë/kryesore të UAMD.</p> <p>(Aneksi nr. 36)</p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ky program studimi plotëson kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ai realizohet me një ngarkesë mësimore, shkencore dhe praktike me 60 ECTS dhe me afat kohor një vit akademik. (<i>Anekset shtesë dhe nr.24</i>)
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësi dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi në përmbajtjen e tij ofron tiparet e një programi të nivelit të dytë në fushën e Administrimit Financiar. Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, dhe thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Këtë e shikojmë në përmbajtjen e lëndëve të programit si dhe në realizimin e praktikës profesionale me mundësi punësimi në këtë treg specifik të punës. (<i>Anekset shtesë dhe nr.24</i>)
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në fushën e Administrimit Financiar me fokus sektorin publik. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive praktike që përfshijnë fushën e financave vendore dhe deri diku qëndrore. Mbështetur në 8 lëndët që ofron programi por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorike shkencor dhe relativisht edhe atë profesional të studentëve. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e diplomës që synohet të jetë aplikative i shërbejnë këtij objektiv në rritjen më shumë të përgatitjes profesionale të studentëve. (<i>Anekset shtesë dhe nr.24</i>)
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore Europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës. Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike ky program përputhet me profilin e zgjedhur që është Administrimi Financiar në sektorin publik. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimin e studentit.




	<p>Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p> <p><i>(Anekset shtesë dhe nr. 24)</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ky program në përgjithësi arrin tu japë studentëve njohuritë e nevojshme teorike praktike. Bazuar në misionin dhe objektivat e tij, programi synon para së gjithash aftësimin profesional dhe deri diku kërkimin shkencor. Në kushtet kur ky program realizohet brenda një viti kalendarik, përfshin trajtimin e 8 lëndëve dhe në total ofron 60 ECTS, aftësimi profesional duhet të zërë më shumë vend në të. Mbështetur edhe nga interesat e studentëve që preferojnë të regjistrohen në këtë program që konsiston në rritjen e aftësimin profesional në fushën e Administrimit Financiar <i>mendojmë se programi në lëndë të caktuara që ofron apo trajton duhet të ketë më shumë trajtime praktike.</i></p> <p><i>Sa më sipër, për ti dhënë përparësi trajtimin profesional mendojmë që 2 lëndë të programit janë kryesisht të nivelit të lartë teorike shkencore dhe kërkojnë bazë të fuqishme teorike nga programi Bachelor. Kështu, lëndët, “Metoda Cilësore dhe Sasiore në Kërkim”, që është e detyrueshme dhe “Makroekonomi e Avancuar” që është me zgjedhje nuk i përgjigjet nivelit të këtij programi po të kemi parasysh se studentë të mundshëm në këtë program janë edhe ata që mund të kenë mbaruar programin Bachelor në Ekonomi apo Biznes dhe që synojnë të marrin njohuri profesionale në Administrim Financiar. Nga ana tjetër, duke pasur kriter minimal hyrës lidhur me notën mesatare nga programi Bachelor, niveli i një pjese studentesh potencial mund të jete i ulët duke mos mundur të përvetësojnë lëndë të tilla të përmendura me lart. Dihet që të trajtosh këtë lëndë duhet një bazë e fuqishme teorike dhe që janë karakteristikë e trajtimin në Master Shkencor. Mendojmë që në kuadër të hapësirave të ndryshimeve në kurrikul mund të shihet mundësia e zëvendësimit të lëndëve të mësipërme me lëndë me profesionale të fushës së programit.</i></p> <p><i>(Anekset shtese dhe nr. 24 dhe 27)</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Krahas plotësimin të kriterëve të hartimit të syllabuseve të lëndëve/moduleve të këtij programi lidhur me elementët e nevojshëm në to GVJ verifikoi që në Departamentin e Administrimit Publik janë miratuar ndryshime në to me qëllim të përmirësimit të përmbajtjes së tyre.</p> <p><i>(Aneksi nr. 36 dhe Takimi me stafin e departamentit)</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për</p>	<p>Programi MP në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar” i pajis studentët që zotërojnë një</p>

<p>programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>diplomë Bachelor në fushën e ekonomisë dhe financës, me njohuri më të thelluara teorike dhe praktike të fushës së Administrimit Financiar duke u dhënë më shumë mundësi në tregun e punës sidomos në sektorin publik. Për të realizuar këtë objektiv edhe për studentët potencial që dëshirojnë të vazhdojnë këtë program por që kanë përfunduar programin Bachelor jo në fushën e ekonomisë, në program janë parashikuar dhe 4 lëndë shtesë ku merren njohuritë baze në ekonomi dhe financë. (Aneksset shtesë dhe nr.24, 27)</p>			
<p>Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Ky program studimi i nivelit MP synon tu japë njohuri dhe aftësi të thelluara profesionale studentëve. Në program dominojnë lëndët karakterizuese në funksion të profilit Administrim Financiar në sektorin publik. të tilla lëndë si “Ekonomiks i Sektorit Publik të Avancuar”, “Financat Lokale dhe Qeverisja”, “Drejtimit Financiar i Avancuar në Organizatat Publike” etj, janë fokusuar pikërisht në profilin e mësipërm që përben dhe veçorinë e këtij programi. Nga diskutimet e zhvilluara me stafin e Departamentit të Administrimit Publik, rezervave të GVJ për nivelin e lartë teorike shkencor lidhur me lëndët karakterizuese të avancuara ju argumentua realizimi nga stafi i trajtimeve praktike të tyre duke zvogëluar ngarkesën me teoritë e avancuara dhe rritjes së fokusit të praktikës. (Aneksset shtesë dhe nr. 24, 27)</p>			
<p>Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi studimor është mbështetur në eksperiencën e programeve të tilla kombëtare por edhe ndërkombëtare. Njëkohësisht programi është edhe një bazë e mirë lidhur me mundësinë në të ardhmen për studentet e diplomuar për të pasur mundësinë e fillimit dhe përfundimit të një Masteri me 120 kredite në të ardhmen. Gjithashtu ky program u mundëson hyrjen në tregun e punës të studentëve në segmentin e Administrimit Financiar në sektorin publik. (Aneksi nr. 24 dhe 73)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në</p>	<p>Ky program studimi i riorganizuar, me 60 kredite mbulohet si me personel akademik me kohë të plotë (PAE) dhe kohë të</p>




<p>realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>pjesshme (PAK). Personeli akademik i programit plotëson kërkesat ligjore dhe kuadrin rregullativ në fuqi i realizuar sipas procedurave standarde të rekrutimit. Nga 12 personel akademik i angazhuar ne këtë program për vitin akademik 2019-2020, 4 anëtarë, staf qe japin mësim në këtë program janë personel me kohë të pjesshme. <i>Pesha e ngarkesës së realizuar nga personeli akademik me kohë të pjesshme në këtë program është 192 orë nga 576 ose thënë ndryshe 33 % të ngarkesës totale dhe pjesa tjetër mbulohet nga personeli akademik me kohë të plotë. Pra, si rrjedhojë konstatohet se përmbushja e kriterit ligjor ku stafi PAE duhet të mbulojë jo më pak se 70 % të ngarkesës totale të programit është pothuajse në kufirin e tij. Bazuar ne faktin se 3 % i tejkalimit te orëve përtej kufirit te lejuar i përket profesorëve te ftuar, një saktësim i planit te ngarkesës rregullon edhe këtë problem.</i></p> <p>Ngarkesa totale e stafit të programit në nivel IAL luhatet nga 48 orë ngarkesës minimale, në 376 orë ngarkesa maksimale.</p> <p><i>(Aneksi nr 24, 81 dhe 114 si dhe Anekset shtesë, Tabela e personelit akademik të programit të studimit për vitet 2016-2020, Ngarkesa e personelit akademik në program dhe në UAMD)</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumenteve që kërkuam gjatë vizitës në institucion rezulton se të gjithë titullarët e lëndëve të angazhuar në zhvillimin e këtij programi studimi kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për të zhvilluar me sukses procesin mësimor në këtë program. Për vitin akademik 2019-2020, i gjithë personeli që mbulon këtë program përbëhet nga anëtarë me tituj akademik dhe grada shkencore. Aktualisht stafi që mbulon këtë program është i përbërë nga 12 anëtarë nga të cilët 8 anëtarë janë PAE dhe 4 anëtarë janë PAK. Stafi i programit përmbush kriteret e kualifikimit akademik ku përfshihen 1 Prof.Dr.; 5 Prof.As dhe 6 anëtarë me gradën Doktor.</p> <p>Përgjegjësi i Departamentit të Administrimit Publik mban titullin akademik Prof.As.</p> <p><i>(Anekset shtesë dhe nr. 81)</i></p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Krahas plotësimit të kualifikimit akademik dhe shkencor personeli i angazhuar në këtë program është i kualifikuar në përputhje me objektin apo fokusin e modulit/lëndës që zhvillon në program. Kualifikimet e stafit dhe eksperienca e tyre përputhen me profilin e programit.</p> <p><i>(Anekset shtese dhe nr. 81)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani,</p>	<p>UAMD në kuadër të bashkëpunimit me institucione apo organizata publike dhe private ka arritur të nënshkruajë një numër marrëveshjesh me to. Nga ana tjetër edhe Departamenti i</p>

<p>vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Administrimit Publik si njësi bazë e programit ka nënshkruar marrëveshje me institucione publike qëndrore dhe vendore në funksion të angazhimit të studentëve të programit në realizimin e praktikës profesionale.</p> <p>Stafi akademik që mbulon këtë program është angazhuar në ndjekjen e procesit të praktikës profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve. Nga vizita në institucion GVJ evidentoi që anëtarë të stafit janë caktuar për të ndjekur si praktiken e studentëve të këtij viti akademik që tashmë kishin filluar semestrin e dytë ashtu edhe si drejtues për punimin e mikrotezës.</p> <p><i>(Aneksi nr. 40, 59, 60 dhe 61)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UAMD ofron personelin ndihmës mësimor shkencor për realizimin e orëve laboratorike apo shërbime të tjera në funksion të procesit mësimor. Nga vizita në institucion ky personel ndihmës mësimor ishte pranë laboratorit të Informatikës ku zhvilloheshin mësimet praktike për tema të caktuara të Kontabilitetit, Drejtimit etj. apo pranë Bibliotekës për ofrimin e literaturës se nevojshme për studentet.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Riorganizimi i këtij programi studimi është rrjedhojë jo vetëm i reflektimit të ndryshimeve ligjore dhe akteve normative në fuqi por edhe rrjedhojë e kërkesave të tregut të punës me specialistë të kualifikuar në Administrimin Financiar në sektorin publik. Në të dy studimet e tregut të punës të realizuar nga Departamenti i Administrimit Publik rezultoi nevoja për specialist të kualifikuar në Administrimin Financiar publik.</p> <p><i>(Aneksi nr. 41 dhe 51)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe takimi me studentët GVJ evidentoi përfshirjen e studentëve në përmirësimet në program. Ky angazhim është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • I drejtpërdrejtë ku studentët janë të përfaqësuar si anëtarë në Senatin Akademik, Grupin e vlerësimit të brendshëm, NJBSC-në etj., të përcaktuara këto si në aktet ligjore dhe nënligjore ashtu edhe në kuadrin rregullativ të institucionit, të shprehura në rregulloret e hallkave




	<p>përkatëse.</p> <ul style="list-style-type: none"> I tërthortë nëpërmjet pyetësorëve të shpërndara për studentët nga Departamenti i Administrimit Publik dhe marrjen e mendimeve prej tyre. Kështu në evidentuam që bazuar në mendimet e studenteve tema atë caktuar në lëndët karakterizuese të zhvilloheshin në laborator. <p>(Aneksi nr. 8 dhe 31)</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.</p>	<p>Nga takimi me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit, GVJ verifikoi se Departamenti i Administrimit Publik mban kontakte me drejtues dhe specialist të institucioneve apo administratës publike, ish studentë të diplomuar në Departamentin e Administrimit Publik. Takimet e zhvilluara ishin fokusuar në nevojat e tregut në këtë sektor, si dhe në kontributin e tyre në dhënien e leksioneve të hapura, marrjen përsipër të studentëve të programit për të zhvilluar praktikën profesionale dhe përmirësimin e programeve.</p> <p>(Aneksi nr. 41 dhe 51)</p>			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe në voja specifike lokale dhe zhvillimi.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i syllabuseve dhe takimet në Institucion, evidentoi që në lëndë të caktuara karakterizuese të programit si rrjedhojë e bashkëpunimit me institucionet publike janë përshtatur disa tema të këtyre lëndëve në funksion të zhvillimeve bashkëkohore të tregut të punës në këtë sektor.</p> <p><i>Megjithatë duhet të theksojmë që bashkëpunimi me institucionet publike qëndrore dhe vendore si dhe me sektorë të tjerë publik është fokusuar kryesisht në gjetjen e mundësive për realizim të praktikave të studentëve se sa të ballafaqimit me idetë dhe praktikat që do të mund të sillnin ndryshime në program. Kjo duhet të jetë një përparësi e institucionit në të ardhmen në bashkëpunimin institucional.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p>Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe</p>




monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacioni të institucionit në dosjen e vetëvlerësimit, nuk rezulton që të këtë udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme mësimdhënëse.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	<p>Bazuar në organigramen e Institucionit si dhe në takimet e realizuara në Institucion, monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësisë mesimdhënëse të stafit akademik dhe ndihmës të programit realizohet në nivel institucional nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë që është organizuar dhe funksionon si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), ndërsa në nivel të njësisë kryesore nga Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike.</p> <p>Këto dy struktura përgjegjëse monitorojnë dhe vlerësojnë periodikisht mësimdhënien nëpërmjet performancës akademike që kryen Departamenti si dhe anketimeve me studentët e programit në fund të çdo semestri. Ky vlerësim paraqitet në formën e një raporti të veçantë dhe u paraqitet instancave përkatëse për analizë të mëtejshme dhe miratim. Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies e prezanton nëpërmjet raporteve periodike pranë instancave vendimmarrëse përkatëse më të larta si dhe pranë Departamentit.</p> <p><i>(Aneksi nr. 2 dhe 30)</i></p>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	<p>UAMD nëpërmjet strukturave përkatëse kryen periodikisht vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Metoda të tërthorta kryesisht në formën e anketimeve me studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Ky anketim zhvillohet dy herë në vit në fund të çdo semestri. Rezultatet e anketimit i bëhen të ditura stafit për të përmirësuar punën në të ardhmen. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të Institucionit, atyre të Fakulteteve dhe Departamenteve ku edhe analizohen si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. • Metoda të drejtpërdrejta që përfshijnë vlerësimin me pike për stafin në bazë të formularit të caktuar. <p><i>(Aneksi nr. 2 dhe 30)</i></p>




<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për monitorimin e mësimdhënies, NJBSC dhe Departamenti i Administrimit Publik përgatitin dhe shpërndajnë në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë e mësimdhënies, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese në nivel Fakulteti dhe Departamenti por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel departamenti, dekanati dhe rektorati. (Aneksi nr. 30)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>NJBSC bazuar në rezultatet e anketimit dhe vlerësimin me pikë të procesit të mësimdhënies për çdo personel akademik mësimdhënës harton një raport periodik vjetor të ecurisë së programeve të nivelit Master mbi problematikën e dalë. Në funksion të kësaj problematike instancat drejtuese në qendër dhe ajo e njësisë bazë mësimore shkencore, parashtrajnë masat që duhen ndërmarrë për përmirësimin e procesit dhe rritjen e cilësisë. Institucioni analizon mbi bazë Fakulteti dhe Departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë edhe opinionin e studentëve. Mbështetur në vlerësimin e personelit akademik, dhe opinionit të shfaqur nga studentët, kryesisht të atyre të organizuar në “fokus grupe” dhe pyetësorët online, institucioni programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik. (Anekset shtese dhe nr. 2 dhe 30)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Mësimdhënia në programin MP në ‘Politika dhe Administrim’ me profil “Administrim Financiar” bazohet në rregulloren mësimore në nivel institucional dhe rregulloren e Departamentit të Administrimit Publik në të cilat përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura; leksione, seminare, leksion/seminare, detyra kursi, ushtrime etj, të organizuara në 8 lëndë, ku janë parashikuar 8 provime me shkrim, praktika dhe tema e diplomës. Lëndët klasifikohen në</p>

	<p>dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje duke ruajtur raportet mes tyre.</p> <p>Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit të çdo lënde dhe në liri të plotë të personelit akademik. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit forma e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar. Në politikën e Institucionit është praktikë që nota e studentit të jetë e “ndërtuar”, kjo do të thotë që studenti testohet gjatë semestrit në secilën lëndë përveç provimit përfundimtar në sezon. Shumatorja e pikëve të mbledhura përbën vlerësimin e tij përfundimtar. Forma e vlerësimit realizohet në përputhje me vendimet e Senatit të UAMD e cila është e veçante në këtë institucion dhe përfshin një sistem 1000 pikesh i cili referuar ECTS e përcakton me notë (1 deri 10) dhe ekuivalentin e notave nga F në A. Ky sistem vlerësimi është i ndare në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 20% apo 200 pike është vlerësimi gjatë semestrit • 30% ose 300 pike provim i ndërmjetëm që zhvillohet në mes të semestrit • 50% ose 500 pike provimi përfundimtar që zhvillohet në fund të semestrit. <p>Mënyra e vlerësimit të studentëve është e prezantuar në syllabusin e çdo lënde.</p> <p><i>(Aneksi nr. 19, 20 dhe 46)</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’i përgjigjet diversitetit dhe nëvojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka kualifikimin e duhur dhe aftësitë pedagogjike bashkëkohore në mësimdhënie rrjedhojë kjo edhe e eksperiencës relativisht të gjatë në procesin e mësimdhënies. Nga ana tjetër nga takimi me studentët e këtij programi GVJ evidentoi faktin e marrjes parasysh të kërkesave të studenteve lidhur me përmirësimin e procesit të mësimdhënies. Si rrjedhojë e kërkesës së tyre, disa lëndë zhvillohen në laborator duke rritur nivelin praktik të mësimnxënies nga studentet.</p> <p><i>(Bazuar në takimin me stafin dhe grupin e studentëve përfaqësues të programit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Bazuar në takimin me stafin e Departamentit, rezulton se UAMD mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodës pedagogjike të tij. Gjatë vitit 2019 disa nga pedagogët e Departamentit të Administrimit Publik që mbulon këtë program kanë marrë pjesë në seminarin e organizuar në institucion me ekspertë të fushës së pedagogjisë. Megjithatë drejtimi kryesor i rritjes së kompetencave pedagogjike të një pjese të stafit kanë qënë vizitat pranë universiteteve homologe jashtë vendit në kuadër të projekteve të bashkëpunimit ERASMUS +.</p>

	<i>(Aneksi nr. 63 dhe 64)</i>			
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Personeli akademik që mbulon këtë program ka kualifikimet e duhura për një proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik, vëmë re që pothuajse të gjithë kanë një formim akademik dhe profesional në fushën e Administrimit Publik dhe të Drejtës Publike, gjë që garanton një proces cilësor mësimdhënieje. <i>(Aneksi nr. 111, 111.1, 111.2)</i>			
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Raporti i përgatitur në nivel Departamenti lidhur me problematikën e dalë nga anketimi me studentët analizohet në njësinë bazë. Nga shqyrtimi i procesverbalit të mbledhjeve në Departamentin e Administrimit Publik, problematikat e dala nga anketimi i studentëve diskutohen me seriozitet në këtë njësi me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Në takimin me studentët e programit ata prezantuan edhe sugjerimin që kishin bërë në Departament për disa lëndë që kishin një nivel të lartë teorike shkencor për tu trajtuar në një nivel me praktik të cilat ishin marre në konsideratë nga pedagogët përkatës të lëndëve. Ky sugjerim theksonte përdorimin më të madh të rasteve studimore.			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.	Vetë eksperiencia relativisht e gjatë në procesin mësimor e numrit më të madh të personelit akademik të programit jep garanci për përdorimin e metodave bashkëkohore në mësimdhënie. <i>(Aneksi nr. 111; 111.1; 111.2)</i>			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga takimi me studentët e programit u evidentua një bashkëpunim reciprok i frytshëm mes tyre dhe personelit akademik. Nisur edhe nga fakti i një numri relativisht të ulët të studentëve në këtë program ata evidentuan faktin e bashkëbisedimit si grup me pedagogët përkatës gjatë prezantimeve të detyrave të kursit në këto lëndë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e në vojshe për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Ky programi mësimor realizohet në një nga dy godinat e reja (godina nr.2) të Kampusit Universitar të UAMD të cilat disponojnë hapësira të mjaftueshme dhe cilësore si dhe infrastrukturën e përshtatshme për këtë qëllim.




	<i>(Aneksi nr. 121, 122, 123 dhe 124)</i>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	<p>Ambientet ku zhvillon mësimin ky program studimor janë funksionale dhe ofrojnë logjistiken e nevojshme në shërbim të procesit mësimor. Laboratori i informatikës ofron kapacitetin e nevojshëm për të realizuar nevojat e programit në shfrytëzimin e kësaj teknologjie. Për zhvillimin e mësimiit pedagoget përdorin video projektorët e vëna në dispozicion nga Departamenti/ Fakulteti në disa nga sallat ku ata nuk janë të vendosur.</p> <p>Mendojmë që laboratorët e informatikës ofrojnë kapacitetet e mjaftueshme për zhvillimin e mësimiit në lëndë të këtij programi si dhe marrëveshja me Crystal System shpk që ka lidhur institucioni krijon mundësi të përshtatëshme për studentët e programit të zhvillojnë lëndë të Kontabilitetit dhe Financës në përmbushje të aftësive praktike të tyre.</p> <p><i>(Aneksi nr. 121, 122, 123 dhe 124)</i></p>
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	<p>Personeli akademik dhe studentet e këtij programi kanë mundësi të shfrytëzojnë rrjetit IT në ambientet e institucionit. Në dispozicion të studentëve është AULA, si hapësirë e dedikuar vetëm për ta. Në këtë sistem studenti mund të regjistrohet në kursin përkatës, të marrë orarin mësimor të kontrolloje vlerësimin etj. UAMD ka faqen e tij zyrtare në internet e cila është e pasur me informacion dhe që përditësohet me të dhëna më të fundit.</p> <p>Mendojmë që “Sistemi i Menaxhimit të të Dhënave të Studentëve” që përdoret aktualisht, tu mundësohet edhe studentëve të ciklit të dytë të studimeve të cilët ende nuk e kanë këtë akses.</p> <p><i>(Aneksi nr. 121, 122, 123, 124, 127 dhe 128)</i></p>
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Për realizimin e këtij programi institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse. Në përgjithësi tekstet bazë janë në gjuhë shqipe, përkthime të autoreve të huaj si dhe botime të autorëve shqiptar. Për të gjitha lëndët e ofruara ka dhe literaturë mbështetëse. Megjithatë, për vetë vështirësitë që ka përdorimi i tyre rrjedhë e diferencave në ambientin ekonomik të vendit tonë me vendet e origjinës së librave të botuara, përdorimi i literaturës së huaj të përkthyer në shqip nga autorë vendas plotësohet edhe me cikle leksionesh dhe shembujsh afër realitetit të tregut shqiptar të përgatitura nga stafi i programit. Kjo sidomos për lëndë specifike lidhur me administrimin vendor.</p> <p><i>(Aneksi nr. 127, 128 dhe 129)</i></p>
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të	Bazuar në vizitën që GVJ realizoi në bibliotekë rezulton se, ka

<p>mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>literaturë të mjaftueshme, tekste mësimore në funksion të studentëve dhe stafit akademik. Në bibliotekën e godinës qendrore na u ofrua lista e titujve të disponueshëm për pedagogët dhe studentët dhe seksioni në ndihmë të programeve të shkencave ekonomike. Nga vizita pranë bibliotekës së UAMD rezulton që hapësira e leximit të saj është optimale . Bazuar në listën e inventarit të librave në fushën e ekonomisë biblioteka ofron një fond relativisht të mjaftueshëm librash në shqip dhe anglisht që janë në ndihmë të studentëve. <i>Megjithatë, GVJ mendon që fondi i librave në dispozicion të studentëve duhet të ishte më i madh me tekste me specifike mbi administrimin financiar në sektorin publik.. Duke u mbështetur në lëndët që zhvillohen në programin MP në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar” rezulton se ka gjithmonë nevojë për shtimin e literaturës lidhur me lëndët karakterizuese të programit. Pavarësisht se titullarët e lëndëve e bazonin mësimdhënien në shumicën e lëndëve që zhvillohen në tekste të huaja të përkthyer ose të autorëve shqiptar numri i teksteve alternative të lëndëve duhet të jetë më i larmishëm si në titujt në anglisht ashtu edhe në shqip. Pasurimi i fondit të bibliotekës me tituj librash në shqip dhe anglisht do pasuronte më tej fondin e bibliotekës dhe do u vinte në ndihmë studenteve.</i></p> <p>Biblioteka punon gjatë orarit 08.00-16:00. Orari është i shpallur në mjediset e institucionit dhe në hyrje të bibliotekës.</p> <p>Biblioteka ka orarin e shërbimeve ekstra edhe në përputhje me oraret mësimore të studentëve për sezone të veçanta si ato të provimeve dhe riprovimeve.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentet kanë akses online në bibliotekën e institucionit duke shfrytëzuar literature e fushës përkatëse për tekste universitare, libra dhe artikuj shkencore , artikuj me një katalog elektronik të pasur. Sektori i IT i universitetit mundëson integrimin e teknologjisë së informacionit në bibliotekë të dy sistemeve me fonde të hapura dhe fonde të mbyllura.</p> <p><i>(Aneksi nr. 127 dhe 128)</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e në veshje për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Laboratorët e informatikës u ofrojnë mundësi përdorimi studentëve të programit për të realizuar programin mësimor. Tema të caktuara të lëndëve që zhvillohen në këtë program realizohen pranë laboratorëve të informatikës edhe për një numër me të madh të tyre nga sa aktualisht ata janë.</p> <p><i>(Aneksi nr. 121, 122, 123 dhe 124)</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-</p>	<p>Aktualisht studentet e programit nuk kanë akses në platformën e-learning e cila është në procesin e ngritjes së saj. Por</p>

line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	pedagogë të caktuar përdorin platformat elektronike të komunikimit on-line në raste të caktuara për komunikim me studentët siç janë google classroom, zoom etj. (Bazuar në vizitën në institucion dhe takimin me studentët)			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuara.	Stafi i programit të studimit me studentët përdorin komunikimin elektronik të zakonshëm (email-in) si dhe hapësirën në AULA. Siç e kemi theksuar përfshirja edhe e programeve të ciklit të dytë të studimeve Master në “Sistemin e Menaxhimit të të Dhënave të studentëve” do rriste më shumë nivelin e komunikimit mes stafit dhe studentëve në një nivel më të lartë dhe efektiv. (Bazuar në vizitën në institucion dhe takimin me studentët)			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Procesi i mbrojtjes së diplomës është përcaktuar në rregulloren e Departamentit të Administrimit Publik. Ky proces paraprihet nga shpallja nga Departamenti i fushave kryesore për punimet e diplomave të cilat u jepen studenteve në fund të semestrit të parë të vitit akademik. Nga takimi me studentet ata ishin informuar me këto tema orientuese diplomimi dhe ishin në fazën e aplikimit pranë Departamentit për miratimin e temës së zgjedhur dhe udhëheqësit përkatës. Nga praktika e viteve akademike të kaluara në pame gjithë procesin e realizimit të diplomimit të studenteve që ishte në koherent me procedure e përcaktuar në rregulloren përkatëse. (Aneksi nr. 78)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në kuadër të plotësisimit të kërkesave ligjore dhe nënligjore UAMD ka ngritur Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) që është një strukturën në nivel institucional. Kjo struktura ndjek dhe vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies të programeve të studimit. NJBSC koordinon punën me njësinë bazë që është Departamenti i Administrimit Publik që mbulon këtë program. Departamenti ka të caktuar një koordinator të përhershëm të programit që mban kontakte të vazhdueshme me NJBSC-në. Në funksion të këtij qëllimi UAMD ka nisur zbatimin edhe të procesit të “Tutorjalit/Monitorimit” në Shtator 2018 dhe në Shkurt 2019

	<p>janë përfshirë në këtë proces edhe programet e ciklit të dytë të studimit. Për grupin e studentëve të këtij programi është caktuar si tutor një anëtar i stafit të Departamentit të Administrimit Publik. Ky anëtar ndjek gjithë problematiken e ecursisë së mësimdhënies dhe problemeve që kërkojnë mbështetje për studentët e programit.</p> <p><i>(Aneksi nr. 12 dhe 90)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike si njësia kryesore dhe Departamenti i Administrimit Publik si njësia bazë ndjekin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme nivelin e cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi. Përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të mbarëvajtjes së programit dhe cilësisë së tij e ka Departamenti i cili bën analiza periodike dhe raporton tek Dekanati i Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike dhe pranë NJBSC-së.</p> <p><i>(Aneksi nr. 12 dhe Takimi me stafin e Departamentit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti i Administrimit Publik si njësi bazë dhe monitoruese e programit nxit zhvillimin e metodave të reja mësimdhënëse nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Organizimit të leksioneve të hapura me personalitete të njohur të fushës së Administrimit Financiar. • Zhvillimin e lëndëve apo pjesë të saj nga profesor të ftuar që kanë eksperiencë të gjatë në fushën e Administrimit Financiar. <p><i>(Aneksi nr. 20 dhe 46)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GJV evidentoi përpjekje të stafit të programit për të rritur kualifikimin e tyre dhe marrë eksperiencë të reja në procesin mësimor e shkencor. Kjo është realizuar nëpërmjet vizitave që anëtarë të stafit kanë realizuar në kuadër të projekteve të shkëmbimit ERASMU-s, pjesëmarrje të stafit në disa projekte kërkimore shkencore si dhe në prezantime të punimeve të tyre në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Vlen të theksohet konferenca ndërkombëtare e organizuar në Mars 2019 nga Departamenti i Administrimit Publik ku referues në të ishin edhe anëtarë të stafit të këtij Departamenti.</p> <p><i>(Aneksi nr. 63, 64 dhe 135)</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Anëtarë të stafit të këtij programi kanë marrë pjesë në seminare të organizuara nga institucioni, që kanë pasur objekt rritjen e nivelit pedagogjik si një drejtim i rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><i>(Aneksi nr. 113)</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e</p>	<p>Stafi akademik që mbulon këtë program studimi jo vetëm tashmë ka eksperiencën e nevojshme por është i përgjegjshëm</p>

programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	për zbatimin në një nivel të lartë të procesit mësimor duke reflektuar kërkesat në rritje, rrjedhojë kjo edhe e konkurrencës nga IAL të tjera. (Aneksi nr. 100, 101 dhe 102)			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Nga takimi me stafin akademik të këtij programi GVJ evidentoi një fryme bashkëpunimi dhe analize mes tyre lidhur me përmirësimin e metodave tradicionale të mësimdhënies në auditor dhe jashtë tij në procesin e monitorimit të praktikave dhe punimit të diplomës.			
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Gjate vizitës në institucion në evidentuam faktin se institucioni ka miratuar një numër profesorësh të fushës akademike apo personalitete të njohur në organizatat publike dhe private për të zhvilluar leksione të hapura për tema të veçante dhe të trajtuara në mënyrë komplekse dhe innovative.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret e posaçme të cilat janë pjesë zbatuese si në nivelin institucional (<i>Rregullore e UAMD</i>), njësisë kryesore (<i>Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike</i>) dhe njësisë bazë (<i>Rregullore e Departamentit të Administrimit Publik</i>). (Aneksi nr. 2, 20 dhe 46)
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në dokumentacionin e ofruar në sistemin e ASCAL dhe vizita në institucion GVJ evidentoi se studentët e programit informohen mbi mënyrën e vlerësimit të njohurive nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> • Informacionit të marrë në webin e institucionit pasi rregulloret në këtë drejtim janë të përfshira në te. • Informacionit që marrin që në fillim të semestrit përkatës nëpërmjet syllabuseve të lëndëve përkatëse të pedagogëve përgjegjës për zhvillimin e tyre.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e	Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në format tashmë të konsoliduar dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar etj, elementë këto që në i evidentuam të përcaktuara në syllabuse.

fituara.	(Aneksi nr. 20 dhe 46)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Vlerësimi i njohurive të studentëve bazohet në praktikatat më të mira të përdorura në IAL. GVJ evidentoi praktika vlerësimi të semestrit të parë në disa nga lëndët për të cilat ishte përmbysur vlerësimi. Njohuritë e marra gjatë gjysmës së parë të semestrit vlerësohen me 40% të sistemit të pikëzimit që realizohet në javën e 7 të semestrit. Ky vlerësim depozitohet elektronikisht dhe materialisht në Sekretarinë Mësimore duke shmangur kështu mundësinë e abuzimeve në vlerësimin përfundimtar. Ky i fundit zë 50 % të sistemit të pikëzimit dhe së bashku me vlerësimin në përgatitjen gjatë seminarit apo detyrës së kursit që ka peshë 10 % përfshijnë gjithë procesin e vlerësimit përfundimtar. Mendojmë se kjo metodë vlerësimi i jep mundësi studentit të angazhohet gjatë gjithë semestrit dhe siguron një vlerësim më objektiv të angazhimit të tij në auditor dhe jashtë tij. (Aneksi nr. 20 dhe 46)
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve përcaktohen në rregulloret përkatëse në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie baze. Për të gjitha lëndët e programit realizohet testimi dhe vlerësimi me shkrim, GVJ evidentoi një praktikë të tillë ku u pa që ruhej sekretit dhe kofidencialiteti i testit si dhe bëhej sekretimi përkatës i tezës dhe zgjidhjes së studentit. Pozitiv është fakti që vlerësimi në testimin e ndërmjetëm (me 40% të pikëve) materializohet që në mesin e semestrit duke mos pasur mundësi ndryshimi në provimin përfundimtar të këtij vlerësimi prej 40 % të pikëve. Kohët e fundit (në Shkurt 2019) UAMD ka ndërrmarë iniciativë për të aplikuar sistemin elektronik të testimit dhe synon ta shtrijë gjërësisht në të ardhmen. (Aneksi nr. 20 dhe 46)
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Për realizimin e testeve dhe vlerësimin e dijeve të studentëve Departamenti i Administrimit Publik bazuar në rregulloret përkatëse në bashkëpunim me sekretarinë mësimore miratojnë komisionet e provimit me një numër anëtarësh stafi jo me pak se 2 ku njëri është titullari i lëndës dhe tjetri është asistenti apo pedagog i fushës përkatëse. GVJ evidentoi nënshkrimin e

	<p>anëtareve të komisionit në procesverbalet e provimeve të lëndëve si dhe praktikave profesionale të firmosura nga 2 anëtarët e komisionit të provimit dhe Përgjegjësi i Departamentit të Administrimit Publik.</p> <p><i>(Aneksi nr. 20 dhe 46)</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Zhvillimi i testimit të vlerësimit bazohet në anonimitetin dhe monitorim nga Departamenti i Administrimit Publik. Kushtet e zhvillimit të provimit janë optimale dhe hapësirat ndërmjet studentëve në këtë proces janë të përshtatshme. Në raste të caktuara shtohet dhe personel mbikëqyrës gjatë zhvillimit të provimit.</p> <p><i>(Aneksi nr. 20 dhe 46)</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nëvojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi me 50% të pikëve të dijeve gjatë vitit jo vetëm i “mban të angazhuar” vazhdimisht studentët por u mundëson të diskutojnë dhe të këshillohen me pedagogët përkatës për të përmirësuar mësimnxënien e tyre. GVJ evidentoi formatin e disa testeve dhe konstatoi që format e pyetjeve dhe ushtrimeve praktike përmbajnë elementë standard të vlerësimit (pyetje me alternative, pyetje me koment, ushtrime etj.).</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në kuadrin rregullator në nivel institucional dhe të njësisë bazë, Departamenti i Administrimit Publik monitoron zhvillimin normal të testimit duke u përpjekur që ai të jetë realist dhe vlerësimi të jete meritë e angazhimit të studentëve me njohuritë e kërkuara duke eliminuar sa më shumë format e kopjimit apo të abuzimit në këtë drejtim. <i>Institucioni nuk ka program antiplagjaturë që të evidentojë këtë mangësi për punimet e diplomave të studentit. Për të minimizuar këtë nga takimi me stafin e departamentit u evidentua rëndësia që i jepej punimit të diplomës të bazuara në raste studimore. Kjo minimizon fenomenin e plagjaturës.</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 20 dhe 46)</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e Departamentit vlerësimi i testimit bëhet brënda 5 ditëve nga zhvillimi i tij. <i>Institucioni ende nuk i mundëson studentëve të ciklit të dytë që ata të shohin në sistem pikët dhe vlerësimin e marrë para se procesverbalet të gjenerohen përfundimisht nga sistemi.</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 20 dhe 46)</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Nga takimi me studentët, GVJ evidentoi faktin se përpara se pedagogu të dërgojë procesverbalin në sekretarinë mësimore lihet një dite reklamimi për ta nëse ndonjë ka paqartësi apo pretendime mbi vlerësimin.</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm.</p>	<p>Praktikat e ankimimit të studenteve lidhur me vlerësimin kanë qënë të pakta në numër, ndërsa nuk ka pasur të tilla për studentët e këtij programi. Por në rastet e evidentuara Departamenti ngre</p>

Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	komision vlerësimi të posaçëm dhe procesi dokumentohet deri në fund. (Aneksi nr. 20 dhe 46)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi bazohet mbi njohuritë e marra në ciklin e parë të studimit. Nga shqyrtimi i syllabusve vihet re që ka një trajtim të shpejtë të koncepteve në financë që janë marrë në programin Bachelor. Ky trajtim është i domosdoshëm në kushtet kur në këtë program kanë mundësinë që ta ndjekin edhe studentë që nuk kanë mbaruar studimet e ciklit të parë në fushën e financës apo ekonomisë. Në funksion të këtij kontingjenti studentesh në program janë parashikuar edhe 3 provime shtesë me lëndë të karakterit bazik në finance dhe administrim.</p> <p>Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në fushën e Administrimit Financiar. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive praktike që përfshijnë fushën e bankave, auditin apo financën.</p> <p>Mbështetur në 8 lëndët që ofron programi por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teoriko shkencor dhe relativisht edhe atë profesional të studentëve. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e diplomës që synohet të jetë aplikative i shërbejnë këtij objektivit dhe rritin më shumë përgatitjen profesionale të studentëve.</p> <p><i>Mbështetur edhe nga interesat e studentëve që preferojnë të regjistrohen në këtë program që konsiston në rritjen e aftësisht profesionale në fushën e Administrimit Financiar me fokus sektorin publik mendojmë se programi në lëndë të caktuara që ofron apo trajton duhet të ketë më shumë trajtime praktike, problematike që e kemi theksuar më lart në këtë raport.</i></p> <p>(Anekset shtesë dhe nr. 24)</p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në	Bazuar në programin mësimor, ky program studimi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e Administrimit Financiar me fokus sektorin publik. Njëkohësisht gjejnë relativisht trajtime në zhvillimin e aftësive në fushën e

gjuhë të huaj).	informacionit në trajtimin e rasteve studimore në financat publike dhe kontabilitet si dhe aftësive humane nëpërmjet trajtimit të lëndës “Menaxhim i Burimeve Njerëzore në Sektorin Publik” që është me zgjedhje. (<i>Anekset shtesë dhe nr. 24</i>)
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Nga takimi me stafin e programit dhe studentët GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit bashkëbisedohej mes pedagogut dhe studentit realizimi i programit të lëndës (bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit).
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Pedagogu i lëndës përkatëse në fund të zhvillimit të mësimit bën një përmbledhje të temave të trajtuara dhe orienton studentët lidhur me testin përfundimtar që do zhvillohet në sezonin e provimeve. (<i>Aneksi nr. 100, 101 dhe 102 dhe Takimin me stafin dhe studentët e programit</i>)
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga takimi me stafin e programit dhe studentët GVJ evidentoi se risitë e reja lidhur me njohuritë në lëndët përkatëse diskutohen kryesisht në orën e mbrojtjes së detyrës së kursit të cilat i referohen praktikave më të reja .
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Bazuar në takimin e zhvilluar e stafin e programit GVJ konstatoi që anëtare të tij realizonin zhvillimin e programit në tema të caktuara nëpërmjet punëve laboratorike. Më e theksuar është në lëndët e Kontabilitetit dhe Administrimit Financiar. Në përputhje me këtë qëllim edhe detyrat e kursit zhvillohen dhe mbrohen në formën e analizave të rasti në laborator.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Stafi i programit diskuton gjatë zhvillimit të programit por sidomos në fund të tij çështje specifike që kryesisht kanë të bëjnë me aplikimin në sektorin publik shqiptar dhe që lidhen me Administrimin Financiar. (<i>Bazuar në takimin me stafin dhe studentët e programit</i>)
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Stafi i programit realizon një bashkëbisedim dhe komunikim të frytshëm me studentët për të marre nga ata sugjerimet me qëllim rritjen e cilësisë mësimdhënëse. Një element i rëndësishëm në funksion të këtij qëllimi është edhe pyetësori që realizohet nga studentët në fund të semestrit ku në të ka rubrike për këtë qëllim. (<i>Bazuar në takimin me stafin dhe studentët e programit</i>)
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Nga takimi me studentet e programit GVJ evidentoi që mbështetja e studentëve konsiston në krijimin e klimës favorizuese dhe të përshtatshme për të realizuar detyrat e kursit. Kjo arrihet nëpërmjet kontakteve apo njohjeve që pedagogu i lëndës ka me drejtues institucionesh duke mundësuar angazhimin e tyre me studentët. <i>Nga ana tjetër GVJ nuk</i>

	<i>evidentoi që studentë të këtij programi të kishin marrë mbështetje financiare në këtë drejtim.</i>			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Në rang institucioni GVJ evidenton forma bashkëpunimi mësimdhënieje me institucione homologe vëndase por edhe ndërkombëtare. UAMD ka mobilitete shkëmbimi me universitete të huaja. Mobilitetet e realizuara përfshije kryesisht shkëmbimet mes stafeve si dhe mobilitete studentësh që kanë studiuar për një periudhë afatshkurtër në universitetet e huaja partnere. <i>Nga studentët e këtij programi nuk evidentuam realizimin e këtyre mobiliteteve pasi mobilitetet e realizuara janë nga programe te tjera..</i> (Aneksi nr. 63, 64, 65 dhe 135)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Praktika profesionale si pjesë e këtij programi studimi, me kohëzgjatje 1 muaj është e parashikuar në rregulloren e UAMD si dhe në rregulloren e Departamentit të Administrimit Publik. Për një realizim sa me mire të këtij komponenti institucioni gjatë vitit 2019 ka nxjerrë disa udhëzime dhe urdhërues. Nga shqyrtimi i tyre në sistemin e ASCAL, evidentojmë se procesi i realizimit të praktikës parashikon një sërë hapash me qellim përmbushjen e misionit që ajo ka. Në udhëzimin e dt.4.2019 të propozuar nga Departamenti i Administrimit Publik dhe miratuar nga Dekani përcaktohet gjithë procedura për këtë komponent, GVJ verifikoi praktika të viteve të tjera në programin MP si dhe procesin në vitin aktual nëpërmjet takimit me stafin dhe studentët e programit. Studentëve u jepet lista e institucioneve të mundshme për zhvillimin e praktikës, lista e kontakteve të tyre, kontrata mes institucionit dhe studentit etj., për të vazhduar me procesin e mbrojtës se saj. Puna përgatitore e Departamentit lehtëson zhvillimin e praktikës sidomos për studentët që nuk kanë mundësi ta zhvillojnë praktikën vetë. Institucioni ofron logjistikën për studentët në funksion të përgatitjes së raportit të praktikës që ata hartojnë për Komisionin e Ngritur për këtë qellim. (Aneksi nr. 48 dhe 48.1)
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave	Departamenti i Administrimit Publik synon që të gjithë studentët e këtij programi ta kryejnë praktikën profesionale pranë

<p>klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>institucioneve publike në sektorin financiar si një mundësi me e madhe për të rritur aftësitë profesionale të studentëve në rang vendor por deri diku edhe në rang qendror, institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, këto marrëveshje bashkëpunimi me mundësi realizimin e praktikave janë me Bashkinë Durrës, Degën Rajonale të Tatimeve, Ndërmarrje në varësi të Bashkisë Durrës etj. (Aneksi nr. 48, 48.1)</p>			
<p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor të këtij programi studimi, praktika profesionale realizohet menjëherë sapo përfundojnë provimet e lëndëve të semestrit të dytë dhe zgjat 1 muaj dhe është vlerësuar me 6 kredite ECTS. Ky vlerësim bëhet pas dorëzimit të raportit të praktikës nga çdo student pranë Komisionit të ngritur për këtë qëllim i cili teston edhe njohuritë profesionale të përfituara në këtë proces. (Aneksi nr. 24, 67 dhe 68)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.9 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e në vojsëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Studentët e këtij programi pas përmbylljes së gjithë detyrimeve dhe mbrojtjes se praktikës kanë të drejtën e mbrojtjes së diplomës përmes një punimi Mikroteze. Procedura e mbrojtjes përfundimtare; diplomimit, është e përcaktuar në rregulloren e Institucionit dhe rregulloren e Departamentit të Administrimit Publik. Ky proces është me i detajuar në udhëzuesin e mbrojtjes se diplomës i propozuar nga Departamenti dhe i miratuar nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike. Në këtë udhëzues jepen detaje lidhur me strukturën e punimit të mikrotezës, listën e pedagogëve udhëheqës, listën e sugjeruar të temave të mundshme orientuese etj. (Aneksi nr. 47 dhe 47.1)</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të në vojshe në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Departamenti i Administrimit Publik si njësi bazë e programit së bashku me strukturat ndihmëse informojnë, ndjekin dhe monitorojnë procesin e mbrojtjes se diplomës me punimin e Mikrotezes. Pas marrjes se informacionit studentët plotësojnë formularin e aplikimit ku përcaktojnë fushën e studimit, strukturën paraprake të tij dhe propozimin për udhëheqësin e punimit. Departamenti i Administrimit Publik përcakton</p>

	<p>udhëheqësit për çdo student të cilët kanë përgjegjësi për mbarëvajtjen e këtij procesi, cilësinë dhe përfundimin në afat. (Aneksi nr. 47 dhe 47.1)</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Për diplomimin e studentëve me propozim të përgjegjësit të Departamentit dhe miratimit nga Dekani ngrihet Komisioni i Provimit të Formimit i cili në vlerësimin e punimit të Mikrotezës bazohet në katër kritere kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ecurinë dhe nivelin e vlerësimit të marrë në mësimet gjatë vitit akademik. • Vlerat teorike shkencore dhe profesionale të punimit. • Vlerësimin që jep pedagogu udhëheqës i punimit të studentit në formularin përkatës. • Nivelin e prezantimit të punimit nga studenti. <p>GVJ konstatoi se kjo praktikë rezultoi e plotësuar. (Aneksi nr. 47 dhe 47.1)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Ne funksion të fushës së punimit të propozuar nga studenti, Departamenti i Administrimit Publik miraton listën e pedagogëve udhëheqës në temat e studentëve. Udhëheqësit e punimeve të Mikrotezës gjatë periudhës së përgatitjes së tij nga studenti mbajnë komunikim të vazhdueshëm duke i orientuar përgjatë kësaj kohe. Roli udhëheqës i pedagogut është këshillues dhe orientues lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit të punimit, shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore nga studenti dhe përfshirja e analizës teorike praktike në punim. (Aneksi nr. 47 dhe 47.1)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Gjatë përpunimit të të dhënave të punimit studentët kanë të gjitha mundësitë teknike dhe asistencën e nevojshme për të realizuar këtë fazë të rëndësishme të punimit në laboratorët që ofron institucioni, Bibliotekën dhe çdo infrastrukturë të dobishme për ta. (Aneksi nr. 127 dhe 128)</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i punimit të Mikrotezës ndjek dhe këshillon vazhdimisht studentin që në fazën e konceptimit deri të përfundimit të punimit. Rol të rëndësishëm ai ka në asistencën që jep sidomos me metodologjinë e punimit që është kyçi i një punimi të suksesshëm, një tjetër ndihme të vlefshme pedagogu udhëheqës jep në mundësinë e shfrytëzimit të të dhënave të institucioneve me të cilat është fokusuar punimi dhe diskutimet apo bashkëpunimin e hallkave financiare në këto institucione. Kjo është e rëndësishme pasi shpesh lidhet edhe me interesin për punimin që ka institucioni për të marrë konkluzione apo edhe rekomandime të problematikës që ai ndjek. Në rastin e punimeve të Mikrotezës për studentët e këtij programi synohet që ai në strukture trajtimi praktik të zerë një peshë të</p>

	konsiderueshme. (Aneksi nr. 47, 47.1 dhe 78)			
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Komisioni i Provimit të Formimit bazuar në katër kriteret e përmendura me lart bën vlerësimin e punimit të Mikrotezes me sistem me pikë (të trajtuar më lart) të cilat konvertohen në notën përfundimtare. (Aneksi nr. 2, 47 dhe 47.1)			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga MASR. Diplomës i bashkëngjitet edhe lista e notave. GVJ verifikoi praktikën përkatëse lidhur me diplomimin e studentëve	Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga MASR. Diplomës i bashkëngjitet edhe lista e notave. GVJ verifikoi praktikën përkatëse lidhur me diplomimin e studentëve (Aneksi nr. 19, 20 dhe 46)			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pas përfundimit të studimeve studenti pajiset me kopjen e plotë zyrtare të programit të studimit. (Aneksi nr. 19, 20 dhe 46)			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Nga vizita në institucion rezulton se procesi i ruajtjes së gjithë dokumentacionit bazohet në kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjithashtu të dhënat e tij ruhen edhe në sistemin informativ të institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit,	UAMD ka krijuar zyrë të veçantë të Burimeve Njerëzore e cila mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik dhe ndihmës akademik. Për shkak të organizimit dhe të shpërndarjes në teren të njërive kryesore të UAMD, shërbimet njerëzore funksionojnë me zyra të shpërndara nëpër çdo Fakultet. Kështu një zyrë e tillë funksionon edhe pranë Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike, pranë të cilit është instaluar programi i studimit




<p>angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Master Profesional, në “Politika dhe Administrim”, me profil “Administrim Financiar”. Nga intervistimi i personelit të Zyrës së Burimeve Njerëzore, por edhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, kjo zyrë është përgjegjëse për të ruajtur të gjithë dokumentacionin procedural lidhur me stafin që angazhohet në Fakultet, ruajtjen dhe përditësimin në çdo vit akademik të të dhënave të personelit efektiv dhe atij me kontratë. Zyra ka ndjekur procedurat për rekrutimin e personelit, ku kriteret i përcakton Departamenti përkatës, në vijim priten aplikimet, kontrollohen nga personeli përgjegjës, dhe procedohen për intervistim. Zyra e BNJ ishte pjesë e të gjitha hallkave të procesit të rekrutimit dhe ndjekjes së progresit të stafit duke siguruar transparencën dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe institucionale. Nga shqyrtimi i dy dosjeve të rastësishme nuk u vërejtën mangësi në dokumentacion.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>UAMD në përputhje me <i>nenin 45 dhe 46</i> të Stautit ka të përcaktuar procedurat e rekrutimit të personelit akademik të cilat janë të reflektuara në rregulloren e programit dhe atë të Fakultetit.</p> <p>Personeli akademik i programit të studimit Master Profesional, “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar” është përzgjedhur mbi bazën e procedurave parashikuar nga Statutit i vjetër i UAMD, por edhe mbi bazën e Statutit të ri (megjithëse periudha korespondon me procesin e rishikimit dhe të miratimit të statuteve të reja të IAL, në reflektim të ligjit të ri për arsimin e lartë në RSH).</p> <p>Departamenti prezanton nevojat për staf akademik, mbi bazën e ngarkesës mësimore dhe numrin e studentëve të planifikuar, harton kriteret referuese dhe pasi miratohen nga Fakulteti publikohen në faqen e internetit të institucionit dhe mediat audiovizive e të shkruara. Çdo kandidaturë për pozicionet e hapura vlerësohet nga një Komision, i cili përbëhet nga drejtues të Rektoratit, Fakultetit, Departamentit dhe titullarit të lëndës që do japë mësim.</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore disponon të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me procedurat e rekrutimit të personelit. Departamenti përcakton kriteret specifike dhe të përgjithshme për vlerësimin e kandidatëve për personel akademik. Shpallja e pozicioneve bëhet publike në faqen web të institucionit. Aplikimet kalojnë një sistem pikëzimi ku 70% zë përmbushja e dokumentacionit dhe 30% intervista.</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura</p>	<p>Nga përzgjedhja e dosjeve të stafit të programit gjatë vizitës në</p>

rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>institucion, rezultoi se në dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore, gjendet dokumentacioni si, kontrata e punës, diploma dhe lista e notave të noterizuara të studimeve universitare, masterit, doktorata, CV etj.</p> <p>Po kështu në dosjet e stafit akademik ka edhe të dhëna lidhur me kualifikimet, pjesëmarrjen në veprimtari kërkimore dhe akademike, brënda dhe jashtë vendit.</p> <p>(Aneksi nr. 115)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëciente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>Për organizimin e programit të studimit Master Profesional me profil “Administrim Financiar”, Fakulteti është mbështetur në vendimin numër 13 datë 11 tetor 2017, të Rektoratit të UAMD. Infrastruktura e UAMD krijon kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. UAMD ka pajisur zyrat e personelit akademik të cilat ofrojnë kushtet e nevojshme nga pikëpamja infrastrukturore për të realizuar punën e tyre akademike, dhe procesin mësimor, kjo e paraqitur në RVB në nivele të larta integrimi të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit edhe nëpër auditore. <i>Por nga vizita në godinë dhe gjatë diskutimeve me grupe të ndryshme, GVJ-së iu referua se pika të dobëta në Departament mbeten logjistika IT dhe programet kompjuterike. Jo në të gjitha rastet pajisjet informatike ishin në dispozicion të punës së pavarur të studentëve.</i></p> <p>(Aneksi nr. 145)</p>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Institucioni ka përdorur kryesisht mobilitetet për kualifikimin e mëtejshëm të stafit, të siguruar më shumë në mënyrë individuale prej vetë stafit. Për këtë stafi i angazhuar në këtë program ka qënë angazhuar me këmbime dhe vizita akademike në Universitetin e Nice në Francë, në Sophia Acropolis University of Nice. <i>Përveç kësaj, nuk janë përdorur forma të</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p><i>tjera për kualifikimin akademik dhe profesional të stafit, dhe veçanërisht në fushën e aftësisimit pedagogjik dhe në atë të komunikimit në të cilat sikurse u konstatua edhe nga inspektimi, rezulton se stafet kanë nevojë.</i></p> <p><i>Po kështu nuk rezulton të jetë organizuar ndonjë trajnim specifik apo të parashikohet një organizim i një programi të caktuar në lidhje me kualifikimin e stafit në shkrim projektesh psh apo në avancimin e metodikave inovative të mësimdhënies.</i></p> <p><i>Gjykojmë se stafet kanë nevojë për trajnime në drejtim të përdorimit të teknologjive të reja të mësimdhënies në distancë apo të formave të tjera të ngjashme.</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 113)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p><i>Institucioni ka angazhuar edhe staf akademik të jashtëm për të plotësuar kërkesat e programit (konkretisht 4 PAK); kriteri 70% e personelit të jetë staf i brendshëm pothuajse është plotësuar (stafi i brendshëm mbulon 67 % të ngarkesës mësimore). Për sa i përket angazhimit optimal, nga evidencat e dorëzuara pas vizitës rezulton se ngarkesa minimale e stafit të programit në nivel institucional është 48 orë dhe ajo maksimale 376 orë.</i></p> <p><i>Departamenti bën përpjekje për të angazhuar si staf akademik edhe personel të ftuar në përputhje me kualifikimet specifike dhe karakteristikat e karakterit ndërdisiplinor të programit të studimit.</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 126 dhe Evidenca Shtesë Ngarkesa e personelit akademik në program dhe në total në UAMD)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në</p>	<p>Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave në sistemin AMS për infrastrukturën e UAMD, GVJ konstaton se institucioni disponon salla leksionesh dhe auditorë për seminare, pranë godinave 1 dhe 2, në Kampusin Universitar.</p>




<p>varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p><i>Sallat e leksioneve mbeten ende për t'u pajisur me kompjutera e projektorë. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si: Burimet Njerëzore, Financa, Biblioteka, etj janë të akomoduar në ambientet e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktiviteteve të tyre. Institucioni ofron gjithashtu ambiente shlodhëse si bar/kafe të cilat janë në dispozicion të stafit dhe studentëve.</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 123)</i></p>			
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga konstatimi gjatë vizitave në institucion, u vu re që ambientet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambiente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike dhe Departamenti përkatës kanë ambientet e mjaftueshme në dispozicion për të realizuar me performancë të mirë programin Master Profesional me profil “Administrim Financiar”.</p> <p>Kampusi Universitar i UAMD ku ndodhet Fakulteti Shkencave Politike-Juridike ka në dispozicion 425 vënde ulëse, për studentët në mjedise dhe ndërtesa të reja duke qenë një ndërtim i ri me standarde bashkëkohore teknike, ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”, sipas të cilit kërkohen 2.5 m² / student.</p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Për stafin akademik dhe mësimor ka shtatë zyra dhe një zyrë në dispozicion për stafin e ftuar me katër poste.</p> <p>Mjediset ku zhvillohet procesi mësimor përmbajnë të gjitha aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të moduleve dhe objektivave formuese të programit të studimit.</p> <p><i>(Aneksi nr. 49, 122, 123)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Për stafin akademik dhe mësimor ka shtatë zyra dhe një zyrë në dispozicion për stafin e ftuar me katër poste.</p> <p>Mjediset ku zhvillohet procesi mësimor përmbajnë të gjitha aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të moduleve dhe objektivave formuese të programit të studimit.</p> <p><i>(Aneksi nr. 49, 122, 123)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p><i>Institucioni ka garantuar kapacitete infrastrukurore për të kryer veprimtaritë praktike lidhur me programin. Gjithsesi sipas konstatimeve të GVJ nuk ka patur ndonjë shëmbull aktiviteti të këtyre llojeve në mjediset e Fakultetit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>




			X	
--	--	--	---	--

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion u konstatua se në dispozicion të studentëve ekzistojnë tre Biblioteka, një në mjediset e godinës në Curila dhe dy në godinat A dhe B të kampusit në Spitallë. Në mjediset e këtyre Bibliotekave studentët kanë mundësi të barabarta për të marrë shërbime si për të studiuar ashtu edhe për të shfrytëzuar literaturën e tyre. Orari dhe shërbimi i ofruar është në funksion të nevojave të studentëve. Mjediset e Bibliotekave janë të hapura edhe në fundjavë.</p> <p>Pranë Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike, dhe në dispozicion të Departamentit të Administrimit Publik është edhe Biblioteka dixhitale, me fonde të hapura dhe hibride që mundëson kërkimin online të informacionit, në sallën e leximit, në skedarët elektronikë, që lehtësojnë punën kërkimore dhe akademike.</p> <p><i>(Aneksi nr. 50 dhe 99)</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezulton se Biblioteka është përgjithësisht e pajisur me literaturë fizike në shqip dhe anglisht, edhe pse nga kontrolli rastësor për një literaturë të detyrueshme në gjuhë të huaj mungonte teksti. Biblioteka është e lidhur me sistemin e RASH për libra online.</p> <p><i>Ka libra në gjuhë shqipe dhe në gjuhë të huaj megjithatë, u konstatua se për disa fusha mungonte literatura dhe në disa libra, tekste universitare, numri i ekzemplarëve ishte shumë i limituar, pa harruar që në ndonjë disiplinë mungonin ekzemplarët.</i></p> <p>Studentët e Masterit Professional “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar” mund të shfrytëzojnë mjediset e Bibliotekës në godinën A, e cila ofron 126 vënde pune e pajisur me kompjutera dhe akses në internet. Biblioteka pasurohet edhe me punimet, materialet didaktike dhe librat universitar që depozitohen në Bibliotekë.</p>




Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Institucioni nuk ka krijuar akses të veçantë në një Bibliotekë online të një botuesi specifik për studentet, por Biblioteka bën pjesë në projektin RASH. (Aneksi nr. 129)			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Ekziston një program kompjuterik i përdorur nga Biblioteka për gjetjen e titujve të librave. Po ashtu kompjuterat e gjetur në Bibliotekë mund të shfrytëzohen nga studentët pa kufizime. Biblioteka vë në dispozicion katalogun e saj elektronik me standard ndërkombëtar, ka akses pa limit në EBSCO për të gjithë. (Aneksi nr. 50)			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Prokurimi i titujve në bibliotekë kryhet në kuadër të buxhetit të institucionit, pas sugjerimeve të përcaktuara nga Dekanet e Fakulteteve. Çdo vit kalendarik, Biblioteka në bashkëpunim me njësitë kryesore, dorëzon pranë drejtorisë së menaxhimit financiar kërkesat për blerje librash dhe pajisje të tjera. <i>Nevojitet të rishikohen mangësitë për të alokuar fondet e nevojshme dhe për t'i mbuluar ato.</i>			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Ky kriter plotësohet, pasi Biblioteka i vihet në dispozicion studentëve edhe gjatë fundjavave. GVJ konstaton se orari i Bibliotekës, është në përputhje me orarin e zhvillimit të programit të studimit. Orari i saj është i deklaruar nga ora 8.00 – 18.00, dhe është nga e Hëna në të Premte, ndërsa ditën e Shtunë punon me orar 8.00-12.00. Në ndihmë të studentëve është edhe sektori elektronik, i aksesueshëm gjatë gjithë javës me orar të plotë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre	Sikurse shprehet nga dokumentacioni dhe u provua edhe gjatë inspektimit në teren, Institucioni disponon një sërë procedurash të cilat rregullojnë menaxhimin e informacionit që lidhet me studentin, <i>por nuk disponon një sistem kompjuterik menaxhimi</i>

<p>nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p><i>dhe administrimi të informacionit të studentit nga krijimi i kartelës dhe regjistrimi i parë deri në diplomim të tij.</i> Dokumentacioni themelor për studentët është: Regjistri Themeltar, që vërteton regjistrimin e studentit, Regjistri i Arritjeve Akademike të studentëve si dhe Regjistri i Lëshimit të Diplomave. Këto regjistra pas diplomimit të studentëve arkivohen në arkivën e shtetit shqiptar dhe të UAMD-së në formë hardcopy dhe elektronike. Gjatë vizitës në institucion, GVJ verifikoi mbajtjen e regjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit Master Profesional “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar”.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p><i>Lidhur me informacionin që ka të bëjë me stafin akademik dhe atë administrativ, nuk rezulton se aplikohet një sistem menaxhimi i mirëfilltë apo i veçantë me aksesin në informacionin e nevojshëm.</i> Referuar takimit të zhvilluar me stafin e burimeve njerëzore, rezulton se Zyra e Burimeve Njerëzore administron të dhënat dhe dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Këto të dhëna ruhen kryesisht në formë manuale por edhe elektronike në disa njësi të UAMD-së si Departamenti, Fakulteti, Universiteti, Zyra e BNJ dhe e Pagave dhe Zyra e Financës.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Monitorimi në kohë reale i aktivitetit të personelit akademik dhe administrativ, bëhet nga Departamenti i Administrimit Publik pranë Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike. Me këtë rol merret kryesisht përgjegjësi i Departamentit dhe drejtuesit e grupeve mësimore dhe kërkimore. Raportet e monitorimit në lidhje me orarin e mësimit, ngarkesën mësimore, etikën e komunikimit etj, përcillen në Fakultet. Gjithashtu sistemi i hedhjes së vlerësimit monitoron në kohë reale ndërhyrjet në sistem. Ky informacion vlerësohet dhe raportohet në organet drejtuese.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sipas praktikës së aplikuar në Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike, Departamenti i Administrimit Publik, raporton pranë zyrës së Zëvendësdekanit për mbarëvajtjen e procesit mësimor në programin e studimeve Master Profesional “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar”.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>(Aneksi nr. 49 dhe 66)</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në</p>	<p>Nga konstatimi i GVJ faqja e internetit të institucionit e përfshin informacionin lidhur me programin dhe stafin dhe njoftime të ndryshme. Përveç kësaj UAMD është shumë aktive edhe në rrjetet sociale, në të cilat ka gjithnjë informacione</p>

faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	lidhur me programin si dhe me aktivitete të tjera që organizon Universiteti dhe Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike. Një pjesë e këtyre njoftimeve janë të emetuara në gjuhë të huaj, kryesisht në anglisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ referuar raportit të hartuar nga GVB dhe <i>(Aneksit nr. 81)</i> konstaton se UAMD harton një raport financiar dhe planin për mbështetjen financiare konform legjislacionit në fuqi, që rregullon veprimtarinë e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. Programi për mbështetjen financiare hartohet nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në UAMD, i cili përllorat koston e mbulimit të një cikli të plotë studimi, për çdo student në të gjitha ciklet e studimeve në institucion.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore, shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekën on-line, detyrimet financiare, gratë vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij	Sipas së njëjtës evidencë në planin financiar përfshihen: <ul style="list-style-type: none"> Të ardhurat e programit nga tarifat e shkollimit, tarifat e regjistrimit, shërbime të ndryshme të IAL, burime të tjera, ku përqindjen më të madhe e zënë dy kategoritë e para. Shpenzime nga granditë e buxhetit të shtetit dhe nga të ardhurat e veta. Po kështu në këtë plan financiar janë parashikuar orët e mësimdhënies dhe elementët e tjerë të koston së programit. Të gjitha kategoritë e kriterit janë të përfshira në këtë plan. <i>(Aneksi nr. 81)</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e	<i>Institucioni ka kryer auditime të brendshëm të përvitshëm; në të janë evidentuar parregullsi, por nuk ka një raport të mirëfilltë të rregullimit të parregullsive dhe nuk ka informacion të posaçëm për këtë program studimi për të cilin hartohet ky raport.</i> Institucioni harton raportin për tre vitet e kaluara për të




shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	evidentuar masën e realizimit të të ardhurave si dhe nivelin e shpenzimeve. Raporti financiar përmban informacion lidhur me tarifat e shkollimit dhe kontributet e tjera, si dhe ndarjen e burimeve financiare.			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Referuar RVB-së konstatohet se në mënyrë periodike Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit pranë UMAD-së bën relacion mbi projekt buxhetin me qëllim që të kontrollojë mbarëvajtjen e programeve të studimit të të gjitha cikleve përgjatë kohës së shtrirjes së studimeve si dhe të identifikojë burimet e mundshme të gjenerimit të të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. <i>Në dokumentacionin e vënë në dispozicion, përveç raporteve financiare, nuk u vërejt ndonjë dokumentacion që tregon ecurinë në vazhdim të programit lidhur me financimin e tij, me vështirësitë me nevojat e posaçme apo lidhur me vështirësitë që has ekzekutimi i këtij programi të studimit.</i> (Aneksi nr. 15 dhe 17)			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje	Rregullorja e institucionit, rregullorja e Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike, rregullorja e Departamentit të Administrimit Publik dhe rregullorja e programit të studimit Master Profesional në “Politika dhe Administrim” me profil




<p>me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>“Administrim Financiar” (neni 30, 31, 32), janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike (neni 33, 34), rregullorja e Departamentit të Administrimit Publik (neni 35, 36) specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. Po kështu Statuti i Ri i UAMD, neni 57, pika 4, neni 64 dhe neni 76 parashikojnë dhe rregullojnë procedurat e regjistrimit dhe të të gjithë karrierës së një studenti në këtë program.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga vizita në institucion, shqyrtimi i dokumentacionit dhe sidomos intervistat me studentët e programit, se politikat dhe procedurat e ndjekura nga hyrja në dalje e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Të gjitha procedurat e shoqerojnë studentin përgjatë programit.</p> <p>Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloren e Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike dhe procesi ndiqet në të gjitha njësitë përkatëse për miratim (Njësi Bazë, Njësi Kryesore, Rektorat, Senat Akademik, MASR) dhe janë në dispozicion të publikut në faqen elektronike zyrtare të UAMD.</p> <p><i>(Aneksi nr. 1, 4, 19 dhe 20)</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve, përparimit të tyre, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e UAMD, të Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike si dhe të Departamentit të Administrimit Publik dhe të programit të studimit. Në këtë program studimi nuk na rezultoi që të kishte patur largime apo transferime studentësh. Nga takimi me Zyrën e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës u konfirmua që institucioni përdor ditët e karrierës për të bërë publike procedurat dhe kriteret e pranimit. Politikat dhe procedurat bëhen publike përmes faqes së internetit apo edhe përmes programit të transparencës së UAMD. <i>Por nga një verifikim që bëri GVJ rezultoi që, nuk kishte asnjë informacion në këtë faqe dhe në mënyrë të veçantë lidhur me këtë program, ndoshta ngaqë numri i studentëve është i ulët.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Në referim të një vendimi të posaçëm të Senatit Akademik si dhe referuar vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se UAMD miraton në fillim të vitit akademik kriteret për pranimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe</p>




	rregulloret përkatëse. (Aneksi nr. 19, 20 dhe 97)			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Përpara çdo fillimi viti akademik, sipas informacionit që GVJ mblodhi gjatë vizitës në institucion, UAMD njeh dhe informon palët e interesuara dhe studentët kandidatë me programin e studimit që ofron dhe kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për çdo program. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet ditëve të karrierës dhe vizitave në gjimnaze. (Aneksi nr. 13 dhe 99)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në rregulloret dhe dokumentat e tjera bazë të universitetit, përcaktohen rregullisht procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin. Po kështu elementë të tjerë të informacionit që ka të bëjë me progresin akademik të studentëve të këtij programi janë parashikuar edhe në rregulloren e programit të studimit. Nëpërmjet Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, rregulloret u vihen në dispozicion studentëve dhe u bëhen të njohura edhe nga takimet që kanë studentët me përgjegjësën e departamentit dhe koordinatorin e programit. (Neni 56 i rregullores së re UAMD si dhe Aneksi 19 dhe Aneksi 20), përcaktojnë kriteret e transferimit të studimeve.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Rregullorja e programit të studimit dhe (neni 56 i rregullores së UAMD), përcaktojnë procedurat dhe kriteret që ndiqen për transferimin e studentëve nga shkolla të tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike, si dhe lejon transferimin e studentëve të UAMD në shkolla të tjera. Njohja e krediteve të fituara nga studimet e mëparshme bëhet nga Komisioni ad-hock i Ekuivalentimit. Studentëve u vihet në dispozicion rregullorja, nëpërmjet të cilës ata njihen me kriteret e transferimeve.

	<i>(Aneksi nr. 2, 3, 19 dhe 20)</i>			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Studentët i njohin rregullat dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive dhe dijeve. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuar në rregulloret e njësisë kryesore dhe asaj bazë, si edhe në programet e çdo lënde. Studentët njihnin që në fillim të vitit akademik, ose të semestrit me programin e lëndës si dhe ata njihen edhe me mënyrën e vlerësimit të tyre në çdo lëndë dhe me detyrimet e secilës lëndë. <i>(Aneksi nr. 2, 3, 19 dhe 20)</i>			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e Universitetit, rregulloren e Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike si dhe në rregulloret e Departamentit të Administrimit Publik dhe në rregulloren e programit të studimit. Këto kritere janë të detajuara veçanërisht në rregulloren e programit përkatës të studimit. Institucioni ka hartuar edhe një udhëzues mbi punimin e diplomës që u bëhet i njohur studentëve nga takimet me përgjegjësën e Departamentit, Koordinatorin e programit, dhe pedagogët udhëheqës të tyre. <i>(Aneksi nr. 2, 3, 20 dhe 46)</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Në fillim të çdo viti akademik institucioni organizon takime të hapura me të interesuarit për ti informuar mbi programet e studimit që ofron ky institucion. Këto takime të hapura janë zhvilluar edhe në shkolla të mesme. Gjithashtu UAMD është shumë aktiv në rrjetet sociale, përgatit fletëpalosje dhe postera për të bërë publike programet e studimit të ofruara prej tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve bëhet në mënyra të ndryshme, i cili fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

54




<p>programit të studimeve.</p>	<p>studentët potencialë, nëpërmjet fletëpalosjeve, komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu informacion mbi strukturën e programit të studimit afishohet në stendat e Universitetit si edhe një informacion i përgjithshëm shfaqen në faqen e internetit të UAMD, ku kurrikula ngelet për tu përditësuar.</p> <p><i>(Aneksi nr. 99)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe në takimin me studentët u konfirmua që studentët që ditën e parë të fillimit të programit të studimeve njihen me rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit dhe në orën e parë të mësimi u bëhet i njohur programi i lëndës. Një pjesë e këtij informacioni afishohet edhe në ambientet e institucionit. Sipas intervistave në institucion dhe RVB-së, në web faqen e UAMD publikohen planet mësimore; edhe nga verifikimi i kryer, informacioni që ofrohet në faqen e internetit është i pranueshëm dhe kurrikula e disponueshme.</p> <p><i>(Aneksi nr. 24 dhe 41)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimet e realizuar në institucion rezulton se institucioni informon si studentët potencialë edhe ata që rregjistrohen, mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi nëpërmjet Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Gjithashtu kjo zyrë mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni, krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare. Për këtë qëllim shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me institucione publike dhe disa biznese private apo publike në qytetin e Durrësit, në mënyrë të veçantë me Bashkinë e Durrësit, dhe me Portin e Durrësit. <i>Ndërkohë nuk rezulton që studentët e këtij programi të bëjnë praktikat në ato subjekte për të cilat thuhet se u përshtatet programi i studimit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Nga takimi i realizuar me studentët rezulton se orari mësimor dhe plani mësimor afishohen në ambientet e Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike, dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e universitetit lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. Studentët e këtij programi e ndjekin mësimin gjatë fundjavës, një mundësi kjo për të ndihmuar studentët e punësuar.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në</p>	<p>UAMD punon fort me komunikimin online në rrjetet sociale</p>

lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	për të mbajtur studentët e informuar mbi programet e studimit dhe aktivitetet në universitet. Gjithashtu, gjatë intervistës me stafin akademik por edhe grupin e punës të hartimit të raportit të vetëvlerësimit u referua se çdo pedagog ofron komunikimin me e-mail me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratorët e teknologjisë. <i>Ndërkohë, jo gjithnjë dhe jo për çdo punë të tyre të pavarur, studentët kanë akses të lirë në pajisjet informatike të Fakultetit dhe Universitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Sekretaria mësimore që mbulon këtë program studimi, mban statistika mbi numrin e të diplomuarve, gjë e cila u konfirmua edhe nga vizita në sekretarinë mësimore të Fakultetit të Shkencave Politiko-Juridike në UAMD. Aktualisht ndjekim studimet në këtë program 14 studentë. Nga viti akademik 2018-2019, rezulton vetëm një student i diplomuar. <i>(Aneksi nr. 82 dhe 84)</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaria mësimore, nëpërmjet rregjistrave përkatës mban informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë, të transferuar dhe të larguar nga programi i studimit për çdo vit akademik. Të regjistruar për herë të parë në këtë program studimi rezultojnë 14 studentë, nga të cilët nuk ka studentë të transferuar apo çrregjistruar. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ mësoi se studentët që duan ta frekuentojnë një lëndë pas riorganizmit të programit, bëjnë një kërkesë në Dekanat dhe me pas meret një vendim nga Dekanati. <i>(Aneksi nr. 82 dhe 84)</i>

<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Sekretaria mësimore regjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi i tyre deri në diplomimin e tyre. GVJ gjatë vizitës në institucion, verifikoi në vënd dhe konstatoi mbajtjen e regjistrave themelor ku çdo student është regjistruar dhe ishte pajisur me numër matrikullimi. Gjithashtu GVJ konsultoi dosje të studentëve të rregjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar. Dosja e studentëve ishte e pajisur me dokumentat si vijon: kontrata, deklarata e studentit, dokumenti i identifikimit, diploma e shkollës së mesme, diploma e studimeve të ciklit të parë dhe lista e notave.</p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ mësoi se ka një listë që mbahet në momentin që pedagogu tërheq regjistrin. Po ashtu UMAD përdor një databazë elektronike excel me të dhënat e studentëve. Studentët që nuk frekuentojnë lëndët i shënohet 0 pikë dhe jo mungese në procesverbalet e provimeve.</p> <p>Detyrat e sekretarisë janë të përcaktuara në rregulloren e sekretarisë mësimore.</p> <p><i>(Aneksi nr. 19)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Në fund të çdo viti akademik, institucioni bën një analizë mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje të studentëve. Për diplomimet në vitet e mëparshme disponohen të dhëna të plota si për notat mesatare në hyrje dhe dalje si dhe punësimin e studentëve të diplomuar që për këtë program studimi rezulton vetëm 1 student i diplomuar .</p> <p><i>(Aneksi nr. 66)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni

Nëpërmjet Statutit të UAMD (*neni 88-90*) institucioni

Adresa: "Rruga e Durrësit"

E-mail: info@ascal.al

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

57




<p>parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>parashikon angazhimin dhe vendimmarrjen e studentëve në aktivitete kërkimore dhe kulturore, ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese të Fakultetit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në dokumentet kryesore të Universitetit, të Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike si dhe në rregulloren e Departamentit të Administrimit Publik dhe rregulloren e programit të studimit Master Profesional në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrimin Financiar”, shprehet qartë që studentët janë të përfshirë në vlerësimin mbi procesin akademik (pjesë e GVB), por nga biseda me grupin e studentëve u kuptua që ata këshillohen me stafin akademik dhe përgjegjësin e Departamentit por nuk përdorin zyrat mbështetëse për këtë qëllim. Sipas Statutit ata kanë formuar edhe Këshillin Studentor. Studentët kishin përfaqësuesin e tyre në Këshillin e Etikës (<i>neni 22 i Statutit të UAMD</i>) por nuk ka përfaqësues të studentëve në zyrën e NJBSC.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>NJSBC organizon periodikisht pyetësorë me studentët ku ata shprehin dhe japin opinionin e tyre për jetën studentore dhe programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>GVJ konstatoi se programet e studimit janë hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve. Statuti i UAMD dhe rregulloret përkatëse parashikojnë procedura joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit dhe njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët që kanë përfunduar një program studimi kanë të drejtën të ndjekin një program të dytë studimi, në të cilin ata mund të përdorin kreditet e grumbulluara në programin e parë të studimit, për lëndë dhe module të njëjta. Për këtë ka komisione të posaçme ad-hoc.</p> <p>Në dokumente është parashikuar njëherësh njohja e studimeve të plota apo të pjesshme të kryera më parë prej studentëve, në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë në RSH.</p> <p>Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendim marrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Si një mënyrë e drejtpërdrejtë në këtë drejtim shërben edhe pyetësori që plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri</p> <p>Statuti i UAMD, rregullorja e Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike dhe rregullorja e programit të studimit, mundësojnë barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit</p>




	të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimimit studentëve si dhe nëpërmjet përcaktimit të procedurës që ndiqet nga institucioni në këtë rast. (Aneksi nr. 1, 19 dhe 20)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-së. Zyra e Komunikimit, Alumni dhe Karrierës në UAMD kryen disa funksione, përfshirë edhe atë të informimit dhe shërbimit ndaj studentëve. Kjo zyrë është e re por shumë aktive në komunikimin përmes rrjeteve sociale. <i>Gjate vizitës GVJ konstatoi se studentët nuk kanë shumë dijeni dhe nuk e shfrytëzojnë këtë zyrë.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .	Nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve në organet vendimarrëse (<i>Statuti UAMD, neni 89</i>), këshilluese dhe të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies, studentët kanë mundësi që të asistojnë në çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. <i>Gjykojmë që të drejtat e studentëve në këtë drejtim, duhet të përcaktohen edhe në rregulloren e Zyrës së Komunikimit, Alumni dhe Karrierës në UAMD.</i> Për Fakultetin e Shkencave Politiko-Juridike dhe Departamentin e Administrimit Publik, funksionon sistemi Pitagora i komunikimit të rezultateve për studentët.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me	Pranë Departamentit funksionon sistemi i tutorialit të kujdesit dhe drejtimit të çdo studenti prej pedagogëve dhe stafit akademik, në punimet e tyre të pavarura dhe në projektet e ndryshem. Referuar (<i>Rregullores së Sektorit të Komunikimit, Alumni dhe Karrierës</i>) janë të përcaktuara qëllimi dhe aspektet e komunikimit në UAMD për ti shërbeyer nevojave për zhvillim të karrierës së studentëve, duke siguruar cilësi të lartë dhe shërbime të ndryshme nëpërmjet këshillimit, konsultimeve

kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	dhe partneriteteve të qëndrueshme, që nga organizimi i përvitshëm i prezantimit të programeve të studimeve në ambientet e Fakulteteve, informimin e studentëve, lidhur me mundësi për pjesëmarrje në konferenca studentore dhe mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, trajnime, praktika, shkolla verore si dhe realizimin e praktikave profesionale pranë institucioneve, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme.			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	Sipas (<i>Rregullores së Sektorit të Komunikimit, Alumni dhe Karrierës</i>), një nga detyrat e kësaj zyrë është edhe përpilimi, plotësimi dhe përditësimi i të dhënave të punësimit për studentët e diplomuar. Nga vizita në institucion, GVJ-së iu konfirmua se kjo zyrë publikon herë pas here njoftime për mundësi punësimi, duke ia dërguar edhe grupeve të studentëve të diplomuar sipas profileve të tyre të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UAMD ka ngritur struktura te tilla si NJSBC qendrore e cila quhet “Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë”, që nga muaji Maj 2019, dhe NJSBC pranë çdo Fakulteti të cilat kanë hartuar procedura për të siguruar cilësinë e programeve. Senati i UAMD ka miratuar rregulloren e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, në të cilën përcakton se Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë, funksionon edhe si NJSBC.




	<p>Gjatë vizitave në institucion GVJ-së iu referua që kjo njësi ka 8 anëtarë në përberjen e saj por në takim u paraqit vetëm kryetari i saj. GVJ konstatoi pas diskutimeve, se kjo njësi e ka të vështirë të monitorojë të gjitha programet e ofruara nga UAMD. Për këtë arsye dhe si pasojë e nevojave imediate të institucionit për akreditimin e disa programeve studimore njëkohësisht, është ngritur NJSBC pranë Fakulteteve përkatëse ku anëtarë janë ose një përfaqësues ose vetë përgjegjësi i çdo departamenti dhe 2 zv/dekanet. Kjo strukturë e dytë mund ti shërbejë si ndihmë njësisë kryesore por, mendojmë që krijon konflikt interesi në vetvete si edhe mbi-vendosje detyrash për përgjegjësit e departamenteve.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike ka krijuar një njësi për sigurimin e cilësisë, në të cilën edhe Departamenti Administrimit Publik ka përfaqësuesin e vet, nga stafi me kohë të plotë, e cila monitoron vazhdimisht dhe vlerëson periodikisht veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore të Departamentit dhe Fakultetit.</p> <p><i>Në përfundim, GVJ mendon se NJSBC pranë UAMD nuk funksionon plotësisht. Si rrjedhim, rekomandojmë që NJSBC qendrore të shikojë mundësinë e shtimit të stafit të saj për të përballuar ngarkesën si edhe ushtruar veprimtarinë e saj më aktivisht dhe e pavarur për të garantuar edhe transparencën. Kjo gjithashtu është e rëndësishme edhe për përmbushjen e rekomandimit Nr.1 të lënë nga grupi i vlerësimit mbi akreditimin institucional (brënda vitit 2017-2018).</i></p> <p><i>(Aneksi nr. 1, 12, 92 dhe 94)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UMAD ka ngritur një sërë mekanizmesh në funksion të sigurimit të cilësisë së brendshme të tilla si: rishikimi i kurrikulave ku sipas vizitave në institucion janë bërë disa takime me biznese, rishikimi i syllabuseve në mënyrë periodike, disa mekanizma të vlerësimit të profesorëve ku një rol të rëndësishëm luan vlerësimi nga studentët.</p> <p>Sistemi operativ i sigurimit të cilësisë përshkruhet në rregulloren përkatëse (<i>Kreu VI mbi Sigurimin e Cilësisë dhe Akreditimin, i Rregullores së Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standardeve</i>). Kjo rregullore përshkruan elementët e syllabusit dhe pyetësoarin e studentëve, por nuk detajon procedurat, udhëzimet dhe format e përdorimit dhe standardet për sigurimin e cilësisë në institucion dhe programin e studimit.</p> <p>Institucioni e monitoron cilësinë nëpërmjet Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë pranë secilit Fakultet</p>

	<p>(Aneksi 12). Në këtë njësi përfshihen personel i brendshëm i Universitetit; <i>por nuk ka anëtarë të jashtëm të pavarur dhe as përfaqësues të studentëve. Po ashtu anëtarët e saj janë mbajtës të disa funksioneve të tjera pedagogjike apo administrative, çka e vë në diskutim funksionin e saj të pavarur, siç e pasqyron organograma.</i></p> <p><i>Sugjerohet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Të detajohet manuali i sigurimit të cilësisë;</i> • <i>Të ketë përfshirje të stafit të pavarur dhe studentëve për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi;</i>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UAMD bën përpjekje të vazhdueshme në kuadër të NJSBC-së, siç u përmend edhe më lart. Gjatë vizitave në institucion u evidentuan përpjekjet që stafi akademik ka bërë për të krahasuar kurrikulën ekzistuese dhe përmirësimin e saj me kurrikula të programeve të ngjashme në vendet e BE-së.</p> <p>Institucioni ka kaluar me sukses vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin institucional dhe është në proces për akreditimin e disa programeve të studimit.</p> <p><i>Sugjerohet pavarësia e stafit në hallkat e sigurimit të cilësisë, rishikimi i instrumenteve për të garantuar përdorshmërinë e tyre dhe përfshirja e përdorimit të instrumenteve në analizën vjetore të NJSBC.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion konstatohet se përfaqësuesi dhe drejtuesi i zyrës së Kurrikulës dhe Cilësisë ishte mjaft i angazhuar për të dhënë kontributin e tij në kuadër të NJSBC-së gjë e cila tregon për formimin e një kulture institucionale të orientuar drejt cilësisë. UAMD ndjek procedura periodike si rishikimi i syllabuseve apo kurrikula e programeve e rishikuar kjo edhe në kuadër të përmbushjes së detyrimit ligjor për përshtatjen me ligjin e ri të arsimit, por edhe si pasojë e politikës institucionale, por NJSBC nuk merr pjesë si hallkë e pavarur në këtë proces pasi përfshin në mekanizmat e vet Komisionin e ngritur në rang Fakulteti. Përveç përdorimit të mekanizmave të mësipërme, sigurimi i cilësisë shtrihet edhe në rekrutimin e stafit, organizimin e programit mësimor, zhvillimin e programit dhe kërkimin. NJSBC në çdo rast është prezent për të siguruar cilësinë dhe për të krijuar një kulturë në rang institucional. <i>Ajo që nevojitet të shënohet është fakti në angazhimin e po të njëjtit staf që vendos detyra, i plotëson dhe i monitoron, duke mos patur pavarësi nga njëra-tjetra.</i></p>




	(Aneksi nr. 12, 110, 141)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Në nivel Universiteti funksionon Drejtoria e Zhvillimit të Kurikulave dhe Standardeve të Cilësisë brënda së cilës funksionon edhe NJSBC. Njësia bazë për menaxhimin e programit të studimit është Departamenti i Administrimit Publik. Kjo njësi bazë së bashku me NJSBC e ngritur pranë Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike, kryen mbikëqyrjen, rishikimin dhe monitorimin e programeve. Siç përmendet edhe tek Raporti vjetor i NJSBC, kjo njësi ka si qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë përmes ushtrimit të funksioneve të saj. Ndërkohë mbetet për tu konsoliduar NJSBC e ngritur pranë Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike e cila është ende në hapat e para të organizimit të saj. Lidhur me funksionimin dhe ekzekutimin e programit, njësia kryesore përgjegjëse është Departamenti.</p> <p style="text-align: center;">(Aneksi nr. 1, 2 dhe 9)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike nëpërmjet Departamentit të Administrimit Publik si strukturë përbërëse e tij dhe përgjegjëse për programin e studimeve Master Profesional në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar”, në bashkëpunim me NJSBC krijojnë komisione ad hoc për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë</p> <p style="text-align: center;">(Aneksi nr. 2)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit institucioni monitoron periodikisht nëpërmjet instrumenteve të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Anketimi i studentëve me anë të një pyetësoari; • Mbledhjet e Departamentit dhe analiza e procesit mësimor e tij, përfshi edhe analizën e programit të studimit Master Profesional “Politika dhe Administrim” me profil




	<p>“Administrim Financiar”.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Analiza në bazë Fakulteti • Vlerësimi i pedagogut në orën mësimore; <p>Përdorimi i mekanizmave është relativisht i ri, prandaj ngelet për t’u vlerësuar efikasiteti i mirëfunksionimit të tyre.</p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p><i>Për sa i përket rezultateve të instrumentave vlerësues e monitorues, edhe pse janë përmendur në Raportin Vjetor të NJSBC, nuk ka një analizë të mirëfilltë të tyre për të kuptuar çfarë është vlerësuar dhe si ka qënë ecuria e vlerësimit, nëse janë marë masa apo ka ndonjë plan aksioni për to. Në fakt ato analizohen dhe përfshihen në Raportet vjetore të Departamentit të Administrimit Publik.</i></p> <p><i>Sugjerohet që rezultatet e mekanizmave të vlerësimit dhe të sigurimit të përfshihen në një proces vetëvlerësimi të stafit akademik. Po ashtu të integrohen raportet vjetore departamentale në atë të NJSBC-së.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p><i>Në raportet vjetore të Departamentit zë pak vënd analiza e kontrollit të vijueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe po kështu edhe në raportin e NJSBC. Gjykojmë se në to duhet të përfshihet një analizë e detajuar e matësve sasior dhe të adresohen mangësitë e ndryshme për përmbushje.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme</p>	<p>Departamenti i Administrimit Publik i cili është përgjegjës për programin e studimit nën vlerësim, bën vlerësime periodike të brendshme për programin e studimit dhe i pasqyron në raportin vjetor të analizës mësimore në nivel Departamenti.</p> <p>Gjithashtu, Departamenti realizon në mënyrë periodike analizën e punës mësimore, ecurinë e programit të studimit duke evidentuar problematikat dhe masat për zgjidhjen e tyre nëpërmjet angazhimit të stafit akademik dhe personelit ndihmës</p>

<p>periodike.</p>	<p>në Departament, por edhe në nivele të tjera më të larta në qoftë se është e nevojshme. Ky vit është viti i parë i akreditimit të programit të studimit dhe UAMD ka përfshirë këto analiza për vetëvlerësim të brëndshëm dhe vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit.</p> <p><i>(Aneksi nr. 9 dhe 30)</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Nga ana e Komisionit dhe e Departamentit të Administrimit Publik, janë realizuar pyetësorë dhe anketime me grupe të caktuara studentore, nga të cilët është grumbulluar informacion dhe materiale që konfirmojnë ndjekjen e programit të studimit.</p> <p>Komisioni i Sigurimit të Cilësisë në UAMD ka një mandat 2 vjeçar dhe në përbërjen e tij ka një anëtar nga çdo Fakultet, për të mundësuar përputhshmërinë me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të këtij programi studimi.</p> <p><i>(Aneksi nr. 9 dhe 30)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike dhe Departamenti Administrimit Publik, për kryerjen e vlerësimit kanë përdorur metoda të tërthorta si sondazhe të studentëve që ndjekin programin e studimit Master Profesional me profil “Administrim Financiar”, sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; intervista të drejtpërdrejta; dëgjime në auditor; testimet paraprake dhe përfundimtare; provime për modulet, praktikë; vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës; leksioneve të hapura etj.. Në UAMD përveç NJSBC, Departamentit të Administrimit Publik, si njësi bazë e ofrimit të programit të studimit, angazhohen edhe zyrat e tjera të institucionit, si ajo e Projekteve dhe Marrëdhënive me Jashtë dhe zyra e Këshillimit të Karrierës.</p> <p><i>Rekomandohet të integrohen gjetjet e zyrave mbështetëse në raportet dhe analizat vjetore departamentale dhe të fakultetit për të garantuar procesin mësimor dhe përputhshmërinë e tij me planet mësimore dhe objektivat e programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e</p>	<p>Si pjesë e rëndësishme e filozofisë së UAMD por edhe në Manualin e Cilësisë, shprehet që studentët inkurajohen të jenë pjesëmarrës aktiv në procesin mësimor, nëpërmjet vlerësimit dhe ofrimit të mendimit të tyre pasi ata nëpërmjet përfaqësuesve janë pjesë e Senatit, Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të UAMD, Këshillave Studentore, Komisionit të Etikes, etj, <i>por në praktikë, u vu re se nuk ka përfaqësues të studentëve të cilët të jenë pjesë e</i></p>




administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	<i>sigurimit të cilësisë së programit.</i> <i>Sugjerohet të këtë përfshirje të stafit të pavarur dhe studentëve për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UAMD harton standardet për sigurimin e cilësisë të institucionit në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Institucioni ka shpërndarë përgjegjësitë për cilësinë në të gjitha nivelet drejtuese (Departament, Fakultet, Rektorat) të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e sigurimit të saj, <i>por personeli mbulon njëkohësisht më shumë se një pozicion administrativ, duke mos garantuar pavarësi në sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Bazuar në rregulloren e NJSBC-së rezulton se ajo përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. <i>NJSBC pranë Fakulteteve përkatëse përbëhet nga përgjegjësi i çdo Departamenti dhe 2 Zv/dekanet dhe nuk ka asnjë përfaqësues të studentëve dhe as raporti vjetor i NJSBC qëndrore nuk është firmosur prej ndonjë përfaqësuesi studentësh.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik,	Departamenti i Administrimit Publik është njësi bazë përgjegjëse për cilësinë e programit. Disa nga anëtarët e departamentit janë pjesë e komisioneve të tilla si Komisionet për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor. Rregullorja e Institucionit, rregullorja e Fakultetit të

ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Shkencave Politike-Juridike dhe rregullorja e NJSBC, parashikojnë angazhimin e anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentëve të programit të studimit në mënyrë të barabartë.			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<i>Nga vizitat në institucion shihet e nevojshme të rekomandohet që studentët të informohen dhe përfshihen në implementimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë.</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	UAMD ka realizuar takime me biznese dhe ka angazhuar edhe bashkëpunëtorë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj, si pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Por gjatë takimeve në institucion nuk qe e mundur të takoheshin përfaqësues të biznesit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Për vlerësimin e moduleve, syllabusave të çdo lënde, ecurinë e procesit mësimor si dhe të stafit akademik, institucioni zhvillon një pyetësor me studentët në fund të çdo semestri. Rezultatet e pyetësorëve i vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit si edhe vetë profesorit. Ato diskutohen edhe në mbledhjet e Departamentit të Administrimit Publik që mbulon këtë program.</p> <p><i>Por në NJSBC përfshihen vetëm personel i brendshëm i Universitetit, nuk ka anëtarë të jashtëm të pavarur dhe as përfaqësues të studentëve. Po ashtu anëtarët e saj janë mbajtës të disa funksioneve të tjera pedagogjike apo administrative, çka</i></p>

	<i>e vë në diskutim funksionin e saj të pavarur, siç e pasqyron organograma.</i>			
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	NJSBC informon në mënyrë periodike Rektoratin, drejtuesit e Fakulteteve, përmes tyre në mënyrë konfidenciale të gjithë stafin akademik rreth rezultateve të kontroleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësisë të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. NJSBC harton një plan vjetor të përvitshëm, ku parashikon të gjitha proceset e kontrollit dhe vlerësimit. Më pas harton raportet me gjetjet përkatëse. Rezultatet e vlerësimit të programeve janë më shumë për përdorim të brendshëm të institucionit se sa të publikut të gjerë.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Bazuar në takimin me NJSBC rezultoni se propozimet e NJSBC shqyrtohen nga organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit për tu reflektuar në vendimmarrje konkrete. Pas rezultateve të vlerësimit, NJSBC-ja harton një raport i cili përcillet tek njësitë bazë dhe kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre, duke dhënë sugjerime për përmirësimin e veprimtarisë. Edhe Departamenti i Administrimit Publik dhe Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike, parashikojnë në programet e tyre vjetore tematika diskutimi mbi rezultatet e vlerësimit të cilësisë dhe korrigjimin apo reflektimin e mangësive të vërejtura.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në raportet vjetore që hartohen nga NJSBC dhe dërgohen në MASR rezultoni se në këto raporte vjetore të vlerësimit të brendshëm pasqyrohen rezultatet e vazhdueshme të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore të institucionit. Gjithashtu paraprakisht këto raporte janë diskutuar edhe në Rektorat, Fakultet dhe Departament si dhe në Bordin e Administrimit, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	UAMD i kushton rëndësi trajnimit të stafit për përmirësimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësimdhënies. UAMD organizon leksione të hapura me studentët, merr mendimin e studentëve, nëpërmjet Këshillit Studentor, mbi çdo program studimor në tërësi, apo për çdo lëndë e pedagog të veçantë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar”, të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit është relativisht i veçantë duke pasur parasysh fushën e administrimit financiar por me fokus sektorin publik u jep studentëve që përfundojnë këtë program më shume mundësi punësimi në këtë segment të tregut të punës.
2. Departamentit i Administrimit Publik si njësi bazë që mbulon këtë program ka ardhur duke u konsoliduar dhe me eksperiencën pedagogjike dhe didaktike të fituar nga stafi i tij garanton cilësi në procesin e mësimdhënies në këtë program.
3. Ambientet e mira infrastrukturore dhe mjedise të përshtatshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie mundësojnë realizimin me sukses të këtij programi..
4. Ngarkesa relativisht e ulët e numrit të studentëve për një pedagog dhe raportet e mira midis pedagogëve dhe studentëve.
5. Institucioni aplikon praktikë eficiente lidhur me vlerësimin e dijeve të studentëve që bazohet krahas aplikimit të sekretimit dhe konfidencialitetit por edhe në minimizimin e ndërhyrjeve dhe ndikimeve në vlerësimin përfundimtar të tyre. Pozitiv është fakti që vlerësimi në testimin e ndërmjetëm (me 40% të pikëve) materializohet që në mesin e semestrit duke mos pasur mundësi ndryshimi në provimin përfundimtar të këtij vlerësimi prej 40 % të pikëve. Fillimi i aplikimit që ne Shkurt 2019 të vlerësimeve elektronike është një arritje pozitive në këtë proces.

Pika të dobëta:

1. Numri i ulët i studentëve të programit është një tregues që i duhet kushtuar një vëmendje serioze nga njësi bazë dhe ajo kryesor për të mos rrezikuar mbylljen e tij në të ardhmen.
2. Bazuar në kurrikulën ekzistuese programi është relativisht i ngarkuar me lëndë kryesisht të karakterit shkencor dhe që ngushtojnë hapësirën e marrjes së njohurive profesionale.
3. Angazhimi i pedagogëve të Departamentit të Administrimit Publik në veprimtarinë kërkimore dhe shkencore është i ulët. Mungojnë projektet kërkimore institucionale si Departament. Veprimtaria shkencore është rastësore dhe individuale.



4. Mungesa e aplikimit të “Sistemit të Menaxhimit të të Dhënave të Studentëve” që për studentët e ciklit të dytë të studimeve ngushton aksesin e tyre në marrjen e informacionit të nevojshëm gjatë procesit mësimor.
5. NJSBC qendrore nuk funksionon plotësisht si pasojë e stafit të pakët në numër për të përballuar ngarkesën si edhe ushtruar veprimtarinë e saj më aktivisht dhe e pavarur për të garantuar edhe transparencën, mungon stafi i pavarur dhe përfaqësuesi i studenëve në përbërjen e NJSBC qendrore.

Rekomandime:

1. Institucioni të ndërmarrë iniciativa të suksesshme marketingu në mënyrë që të rrisë numrin e studentëve të ardhshëm në këtë program. Një drejtim tjetër i kësaj iniciative do jetë dhe bashkëpunimi pranë njësive publike të pushtetit vendor dhe qendror për të tërhequr specialistë të punësuar që të vazhdojnë këtë program.
2. Brenda hapësirave të lejuara të shikohet mundësia e “lehtësimit” të programit nga lëndë kryesisht të karakterit shkencor si dhe të ulet nr i madh i lëndëve me zgjedhje.
3. Fakulteti dhe Departamenti te zgjerojnë me shume bashkëpunimin dhe shkëmbimin e eksperiencës me Departamente homologe, brënda dhe jashtë vëndit në drejtim të kërkimit shkencor.
4. Institucioni të financoje përmirësimin në sistemin informatik që tu japë me shumë akses studentëve në përdorimin e pajisjeve informatike të Fakultetit dhe Universitetit.
5. NJSBC qendrore të shikojë mundësinë e shtimit të stafit të saj për të përballuar ngarkesën si edhe ushtruar veprimtarinë e saj më aktivisht dhe e pavarur për të garantuar edhe transparencën. Sugjerohet të këtë përfshirje të stafit të pavarur dhe studentëve për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi. Kjo gjithashtu është e rëndësishme edhe për përmbushjen e rekomandimit Nr.1 të lënë nga grupi i vlerësimit mbi akreditimin institucional (brënda vitit 2017-2018).
6. Institucioni lidhur me auditimin të hartojë raport të veçantë për ndreqjen e parregullsive të vërejtura si dhe të këtë raport të mirëfilltë për këtë program.
7. Të financohet më shumë në rritjen e një numri më të madh botimesh në gjuhën shqipe por edhe në anglisht që janë të fokusit të programit.
8. Te shihet mundësia që për disa nga lëndët e programit të këtë numër të ndryshëm kreditesh bazuar në sistemin e përcaktimit të tyre që bazohet në nivelin e angazhimit në auditor dhe jashtë tij dhe karakteristikat e ndryshme që kanë këto lëndë.



9. Institucioni, njësia kryesore dhe ajo bazë të shikojnë mundësinë e përfitimit të mobiliteteve edhe për studentet e këtij programi të cilët nuk e kënë pasur këtë mundësi.
10. Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standardeve të axhustohet duke përfshirë edhe detajimet lidhur me procedurat, udhëzimet dhe format e përdorimit dhe standardet për sigurimin e cilësisë në institucion dhe programin e studimit.
11. Rekomandohet të integrohen gjetjet e zyrave mbështetëse në raportet dhe analizat vjetore të departamentit dhe të fakultetit për të garantuar procesin mësimor dhe përputhshmërinë e tij me planet mësimore dhe objektivat e programit të studimit.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Professional Master in “Policies and Administration” with profile “Financial Administration” of the Institution of Higher Education, University "Aleksandër Moisiu", Durrës.

Strengths and affirmations:

1. The study program is relatively special, considering the orientation on financial administration direction of the public sector. It gives to the students that terminate this program more employment possibilities on this part of labor market.
2. The Public Administration Department, as Base Unit that manages this program, have been consolidated on the pedagogic and didactic experience gained from staff. This guaranties the quality on the teaching process for this program.
3. Well organized premises with the right and comfortable maintenance on lecturing and learning, create possibilities on the successful realization of this program.
4. The limited number of students to a lecturer helps on good relationship of students and teachers.
5. The institution applies efficient practices on the studies evaluation for students. This evaluation is based on confidentiality and individual secret codification, as well as reduction of interventions for non-merit favors/support. It is positive that the mid-term exams with 40% if evaluated since the mid-semester (there is no chance to change the last exams. The electronic evaluation (grades) since February 2019 is a positive achievement on this process.

Weaknesses:



1. Limited number of the students in this program is an indicator that needs special attention from the main and base units, as the program can be terminate (closed) in the future.
2. Based on the existing curricula, the program is relatively over-loaded with scientific classes that reduce possibilities for the increase the professional skills.
3. The engagement of DPA lecturers on the research and scientific activities has been in low levels. There aren't research projects from the DPA, while the research has been on the individual basis (occasionally).
4. There is no application (evidence) on "System of Management for students details/information". For the second level students have limited access to receive information during the teaching process.
5. The main IQAU does not function fully as a result of the small number of staff to cope with the load as well as exercise its activity more actively and independently to guarantee transparency; the independent staff and the representative of the students in the composition of the main IQAU are missing.

Recommendations:

1. The institution should initiate marketing and publicity aiming the increase on number of students in the future. The second direction of this initiative will be the collaboration with local and central government units attracting employs to apply for this program.
2. Within the permitted (allowed) spaces should be considered the possibility on "gently reduction" of the program from scientific subjects, as well as reduction of alternative choice subjects.
3. The Faculty and the Department must increase their collaboration and exchange experience with similar departments in and outside Albania, due to the improvement of scientific research.
4. The institution must fund the improvement of IT network. This gives more access to students for the use of electrical appliances of Faculty and Department.
5. The main IQAU to look at the possibility of increasing its staff to cope with the load as well as exercise its activity more actively and independently to guarantee transparency. It is suggested the involvement of independent staff and students to perform quality assurance functions with integrity and independence. This is also important for the fulfilment of the recommendation No. 1 left by the assessment group on institutional accreditation (within the year 2017-2018).



6. The institution should draft a proper audit report for the correction of reported irregularities for this study program.
7. The increase on the funding levels for Albanian and English publications related to the focus of program.
8. The evaluation system with credits which are calculated on the engagement basis in and outside classroom should be taken into consideration as per different characteristics on these subjects.
9. The Institution, main and base units should explore the possibilities of funding through mobility, as the students of this program are missing this chance.
10. The regulation on the Curricula and Standards Department must be detailed with the procedures, instructions (guidance), forms to be used and standards that aim quality for both institution and study program.
11. It is recommended that findings of support offices should be considered and included on annual reports of department/faculty. This guaranties the study process, matching with curricula and plans, as well as objectives of study program.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	


